



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë
2019 - 2020
(energji elektrike, gaz natyror dhe naftë)

Prishtinë, dhjetor 2021



PËRMBAJTJA

1. BAZA LIGJORE	5
1.1 Pjesëmarrësit dhe roli i tyre në sektorin e energjisë.....	6
1.2 Roli i autoritetit rregullativ	7
1.3 Dokumentet strategjike për këtë dokument	8
1.3.1 Strategjia e energjisë.....	8
1.3.2 Bilancet e energjisë.....	8
1.3.3 Planet Zhvillimore të rrjetit	9
1.3.4 Adekuacia (mjaftueshmëria) e gjenerimit	9
1.4 Masat nxitëse për ndërtimin e kapaciteteve nga BRE-të	9
1.5 Masat e emergjencës në furnizimin e energjisë	11
2. SEKTORI I ENERGISË ELEKTRIKE	13
2.1 Tregu i energjisë elektrike	13
2.2 Monitorimi i sigurisë së furnizimit	15
2.3 Sistemi elektroenergjetik	15
2.3.1 Sistemi i transmetimit.....	15
2.3.2 Rrjeti i shpërndarjes.....	21
2.3.3 Kualiteti i furnizimit.....	24
2.4 Gjenerimi i energjisë elektrike	26
2.4.1 Kapacitete gjeneruese dhe gjenerimi i energjisë elektrike në vitet paraprake..	26
2.4.2 Operimi i njësive gjeneruese	28
2.4.3 Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.....	29
2.5 Kërkesa për energji elektrike dhe ngarkesa maksimale	31
2.6 Balancimi i kërkesës dhe prodhimit në vitet paraprake	35
2.7 Parashikimi i kërkesës dhe gjenerimit për periudhën 2019 - 2028 ...	36
2.7.1 Parashikimi i kërkesës për skenarë të ndryshëm të rritjes ekonomike	36
2.7.2 Parashikimi i gjenerimit të energjisë elektrike	38
2.7.3 Balanca mes prodhimit dhe konsumit	40
3. SEKTORI I GAZIT NATYROR	Error! Bookmark not defined.
3.1 Përshkrimi i përgjithshëm.....	42



3.2	Korniza ligjore dhe institucionale.....	42
3.3	Përshkrimi i rolit të autoritetit rregullator dhe/ose autoriteteve të tjera	42
3.4	Kapaciteti aktual i prodhimit dhe importit.....	43
3.5	Investimi në prodhim dhe import në tre vitet e ardhshme	43
3.6	Progresi në projektet e mëdha infrastrukturore	43
	Projekte të rëndësishme të interkoneksionit ndërmjet ose brenda shteteve anëtare	43
4.	SEKTORI I NAFTËS	Error! Bookmark not defined.
4.1	Korniza ligjore dhe institucionale.....	Error! Bookmark not defined.
4.2	Furnizimi vendor i naftës bruto dhe produkteve të naftës	45
4.3	Importi dhe konsumi i naftës bruto dhe derivateve të naftës.....	Error! Bookmark not defined.
4.4	Varësia nga importet dhe origjina e karburanteve të importuara.....	Error! Bookmark not defined.
4.5	Rezervat e naftës bruto dhe të derivateve të naftës	48
4.6	Infrastruktura e naftës	Error! Bookmark not defined.
4.7	Tarifa doganore e importit/eksportit.....	48
4.8	Rregullimi i çmimeve, roli i autoritetit rregullator.....	49
5.	KONKLUZIONE	50



Shkurtesat

APEX	Bursa për shkëmbim e Shqipërisë (Albanian Power Exchange)
BDS	Skenari i kërkesës bazë (Base demand scenario)
BE	Bashkimi Evropian
BPV (GDP)	Bruto Prodhimi Vendor
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
EC	Komuniteti i Energjisë (Energy Community)
EMS	Operatori i sistemit të transmetimit serb
GLN	Gaz i lëngëzuar i naftës
HC	Hydrocentral
ITC	Kompensimi mes OST-ve
KEDS	Kompania Kosovare për Shpërndarje të Energjisë Elektrike
KEEJL	Komuniteti i Energjisë i Evropës Juglindore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
KESCO	Kompania Kosovare për Furnizim me energji elektrike
KKK	Komisioni i Kosovës për Konkurrencë
KOSTT	Operatori i Transmetimit, Sistemit dhe Tregut në Kosovë
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
LFC	Kontrolli Frekuencë-Ngarkesë (Load Frequency Control)
MBE	Marrëveshje për Blerje të Energjisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NKEC	Kompaninë e Re Kosovare të Energjisë Elektrike
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PEE	Pëlqimi Elektroenergjetik
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SoSSoK	Deklarata mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë
TC	Termocentral
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

1. BAZA LIGJORE

Kuvendi i Kosovës, në korrik 2016, ka miratuar ligjet e reja për sektorin e energjisë, në përputhje me pakon e tretë të legjislacionit për energji të Bashkimit Evropian. Miratimi i këtyre ligjeve ka për objektiv krijimin dhe funksionimin e efektshëm dhe konkurrues të tregut të energjisë. Ligjet e aprovuara për energji janë:

- Ligji Nr. 05L-081 Për Energjinë,
- Ligji Nr. 05L-085 Për Energjinë Elektrike,
- Ligji Nr. 05L-084 Për Rregullatorin E Energjisë,
- Ligji Nr. 05L-082 Për Gazin Natyror.

Deklarata mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë SoSSoK (ang. Security of Supply Statement of Kosovo) bazohet në ligjet e sektorit të energjisë. Ligji për Rregullatorin e Energjisë obligon ZRRE që çdo dy vite të përgatisë dhe publikoj raport mbi monitorimin e sigurisë së furnizimit dhe i njëjti të i dërgohet SKE. Deklarata përmban strukturën e propozuar nga SKE për fushëveprimin e sektorëve të energjisë elektrike, gazit natyror dhe naftës, si dhe është në pajtim me direktivat përkatëse për energji elektrike 2009/72 EC, gaz natyror 2009/73 EC dhe për naftë 2009/28 EC.

Deklarata për monitorimin e sigurisë së furnizimit hartohet bazuar në nenin 29 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, që kërkon të përgatitet një vit pas hyrjes në fuqi të Traktatit. Kjo deklaratë duhet të përmbajë këto lëmi: diversitetin e furnizimit, sigurinë teknologjike, dhe origjinën gjeografike të karburanteve të importuara. Përveç kësaj deklarata për monitorimin e sigurisë së furnizimit në tregjet e energjisë elektrike dhe gazit natyror do të trajton në mënyrë të veçantë:

- a) *Balancën mes furnizimit/kërkesës në tregun kombëtar,*
- b) *Nivelin e kërkesës së pritur në të ardhmen dhe furnizimin përkatës në dispozicion,*
- c) *Kapacitetet e planifikuara për ndërtim në të ardhmen,*
- d) *Nivelin dhe cilësinë e mirëmbajtjes së rrjeteve,*
- e) *Masat për të mbuluar kërkesën e pikut, dhe*
- f) *Masat për trajtimin e dështimit të një apo më shumë furnizuesve.*

Në bazë të direktivave të lartpërmendura, *“Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë monitorimin e çështjeve të sigurisë së furnizimit. Në rastet kur Shtetet Anëtare e konsiderojnë të përshtatshme, ato këtë detyrë mund t’ua delegojnë autoriteteve rregullative.”*

Sipas nenit 42 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE është përgjegjëse për monitorimin dhe ndërmarrjen e veprimeve të specifikuara në këtë ligj për promovimin dhe ngritjen e sigurisë së furnizimit në baza afatshkurtra dhe afatgjata. ZRRE përgatitë dhe publikon çdo dy vite, një raport që përshkruan gjetjet nga monitorimi i çështjeve të sigurisë së furnizimit, si dhe detajet e masave të ndërmarra apo që pritet të ndërmerren për t’i adresuar të njëjtat. Dokumenti përmbledhë të dhëna për vitet paraprake me theks të veçantë për dy vitet e fundit të cilat nuk janë mbuluar nga dokumenti i ngjashëm paraprak, si dhe parashikimet për vitet e ardhshme.

Komisioni Evropian ka dhënë indikacione se obligimet sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë nuk do duhej të jenë më të gjera se sa ato që përcaktohen me *acquis* të BE-së. Prandaj, mjafton që të sigurohet pajtueshmëri me kushtet e sigurisë së furnizimit që përcaktohen me *acquis* për energjinë.

1.1 Pjesëmarrësit dhe roli i tyre në sektorin e energjisë

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE); është agjenci e pavarur, e themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas neneve 119.5 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të sektorit të energjisë.

Detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, ku përfshihen: krijimi dhe funksionimi efikas, transparent dhe jo-diskriminues i tregut të energjisë; përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë; përcaktimi i kriterëve dhe kushteve për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja; monitorimi dhe përkujdesja për përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji; caktimi i kriterëve dhe kushteve të arsyeshme për veprimtaritë energjetike në bazë të metodologjisë tarifore.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE); mes tjerash është përgjegjëse për strategjinë dhe politikat e sektorit të energjisë (përgatitja dhe implementimi), zhvillimin e legjislacionit sekondar, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe shfrytëzimin racional të energjisë, koordinimin e donatorëve dhe joshjen e investimeve;

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM); është agjenci e pavarur e themeluar në bazë të neneve 119, paragrafi 5, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. KPMM rregullon aktivitetin minerar në Kosovë në pajtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale, aktet nënligjore të nxjerra në bazë të tij dhe me Strategjinë Minerare.

Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK); është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në bazë të Ligjit për Konkurrencën, Nr. 2004/36. Komisioni Kosovar i Konkurrencës është organ i pavarur dhe ka përgjegjësi për promovimin e konkurrencës mes ndërmarrësve, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve në Kosovë.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) dhe si Operatori i Tregut (OT); -KOSTT është themeluar më 1 korrik 2006 si rezultat i ristrukturimit të sektorit të energjisë dhe është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe operimin e sistemit të transmetimit elektroenergjetik në Kosovë; sigurimin e qasjes së hapur dhe jo-diskriminuese për palët e treta; funksionimin e tregut të ri të energjisë; sigurimin e kushteve që inkurajojnë konkurrencë në Kosovë; dhe bashkëpunimin me Operatorët e Sistemit të Transmetimit në vendet fqinje.

KOSTT funksionon si Operator i sistemit të Transmetimit dhe si Operator i Tregut.

Kompania Kosovare për Shpërndarje të energjisë elektrike (KEDS); KEDS është ndërmarrje private në kuadër të konzorciumit Limak-Çalik që kryen aktivitetin e shpërndarjes së

energjisë elektrike, mirëmbajtjen e rrjetit të tensionit të mesëm dhe të ulët, përfshirë njehsorët.

Kompania Kosovare për Furnizim me energji elektrike (KESCO) J.S.C; – është ndërmarrje e cila në vitin 2014 është krijuar si pasojë e shturjes legale mes operatorit të shpërndarjes dhe furnizuesit, që ka hyrë në fuqi më 01.01.2015. Kjo ndërmarrje kryen aktivitetin e furnizimit përfshirë edhe aktivitetin e shërbimit të furnizuesit universal.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK); është ndërmarrje energjetike që kryen aktivitetet në mihje të thëngjillit dhe gjenerim të energjisë elektrike që përfshinë rreth 95 % të energjisë së prodhuar në vend.

1.2 Roli i autoritetit rregullativ

Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji.

Rregullatori i Energjisë është agjencie pavarur, autonom nga çdo dikaster i Qeverisë në ushtrimin e rregullimit ekonomik të sektorit të energjisë (energjisë elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror). Ligji për Rregullatorin e Energjisë përcakton detyrat, funksionet dhe autorizimet ekzekutive të ZRRE-së, siç janë:

- *Lëshimi, modifikimi, pezullimi, bartja apo tërheqja e licencave për të kryer veprimtari energjetike;*
- *Mbikëqyrja, monitorimi dhe sigurimi i pajtueshmërisë me licencat;*
- *Monitorimi i funksionimit të tregjeve të energjisë në Kosovë, përfshirë kushtet e qasjes së palëve;*
- *Nxjerrja e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit dhe sistemeve të tubacioneve të gazit, përfshirë linjat direkte të energjisë elektrike dhe tubacionet direkte;*
- *Zhvillimi dhe miratimi i metodologjive tarifore, dhe përcaktimi dhe miratimi i tarifave për shërbimet e rregulluara;*
- *Përshkrimi i kushteve të përgjithshme të furnizimit me energji;*
- *Monitorimi dhe marrja e veprimeve të përcaktuara me ligj për promovimin dhe ngritjen e sigurisë së furnizimit me energji;*
- *Monitorimi i shturjes efektive dhe zhvillimit të konkurrencës në sektorin e energjisë; dhe*
- *Shqyrtimi i masave për mbrojtje të konsumatorëve dhe zgjidhja e kontesteve në sektorin e energjisë.*

1.3 Dokumentet strategjike për këtë dokument

1.3.1 Strategjia e energjisë

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës është dokument themelor dhjetëvjeçar për zhvillimin e sektorit të energjisë. Në intervale kohore prej jo më shumë se tre (3) vjet, bëhet rishikimi i Strategjisë dhe përgatitet Strategjia për periudhë të ardhshme dhjetë (10) vjeçare. Bazuar në Strategji, përgatitet dhe miratohet Programi për Zbatimin e Strategjisë për periudhën tre (3) vjeçare.

Roli, rëndësia, përmbajtja si dhe procedurat e përgatitjes së dokumentit Strategjia e Energjisë bazohet në Ligjin për Energji nr.05/L-081. Strategjia e Energjisë mbështetet në politikat ekzistuese dhe dokumentet strategjike të Qeverisë së Kosovës, në rezultatet e analizave të bëra dhe në studimet e realizuara për sektorin e energjisë.

Strategjia e Energjisë ka objektiv themelor krijimin e kushteve për furnizim të besueshëm dhe të sigurt me energji, duke i zhvilluar kapacitetet prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse, dhe duke pasur në konsideratë diversifikimin e burimeve, shfrytëzimin eficient të energjisë, shfrytëzimin maksimal të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, krijimin e tregut konkurrues, zhvillimin e sistemit të gazit natyror si dhe mbrojtjen e mjedisit.

1.3.2 Bilancet e energjisë

Parashikimi i kërkesave për energji elektrike, gaz natyror dhe energji termike, mënyra dhe masat e plotësimit të saj përcaktohen në Bilancin Vjetor të Energjisë dhe në Bilancin Afatgjatë të Energjisë që miratohen dhe publikohen nga Rregullatori.

Komponentët e detyrueshme të bilanceve vjetore të energjisë janë:

- parashikimi i kërkesës për çdo muaj të vitit vijues;
- parashikimi i furnizimit për plotësimin e kërkesës;
- parashikimi i konsumit të lëndëve të para të energjisë, nivelet dhe kapacitetet rezervë;
- niveli vjetor i kapacitetit rezervë (kufiri i rezervës) i centraleve të energjisë dhe pajisjeve;
- nivelet e duhura të rezervave operative çdo vit dhe kriteret lidhur me efikasitetin e energjisë për çdo vit

Komponentët e detyrueshëm të bilanceve afatgjata të energjisë janë:

- parashikimi i kërkesave;
- parashikimi i furnizimit për mbulimin e kërkesave;
- mënyra për përmbushjen e kërkesave;
- një listë të niveleve të nevojshme të deponimit dhe kapacitetit rezervë të nevojshëm për sigurimin e shkallës së planifikuar të qëndrueshmërisë (stabilitetit) të furnizimit.

Bilanci vjetor i energjisë do të miratohet në fund të vitit aktual, për vitin e ardhshëm.

Bilanci afatgjatë i energjisë miratohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare. Azhurnimet e bilancit afatgjatë të energjisë miratohen çdo dy (2) vjet.

1.3.3 Planet Zhvillimore të rrjetit

Çdo vit, sipas legjislacionit, Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror duhet t'i dorëzojnë Zyrës së Rregullatorit për Energji Planin dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar. Plani i zhvillimit të rrjetit përmban masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.

Plani i zhvillimit dhjetë (10) vjeçar i rrjetit në veçanti duhet të:

- njofton pjesëmarrësit kryesor të tregut për infrastrukturën që nevojitet të ndërtohet apo të përmirësohet gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme;
- përmban të gjitha investimet që janë në zhvillim dhe identifikon investimet e reja që do të ekzekutohen gjatë tre (3) vjetëve të ardhshme; dhe
- ofron një kornizë kohore për të gjitha projektet e investimeve.

Rregullatori aprovon planet zhvillimore, si dhe monitoron dhe vlerëson zbatimin e planeve zhvillimore të rrjetit.

1.3.4 Adekuacia (mjaftueshmëria) e gjenerimit

Operatori i Sistemit të Transmetimit përgatit dokumentin "Plani i Adekuacisë së Gjenerimit" në pajtim me Nenin 9 të Kodit të Rrjetit - Kodit të Planifikimit. Qëllimi i këtij dokumenti është t'i njoftoj palët pjesëmarrëse të tregut të energjisë elektrike dhe Zyrën e Rregullatorit të Energjisë lidhur me vlerësimin e adekuacisë së gjenerimit të sistemit elektroenergjetik të Republikës së Kosovës për mbulimin e ngarkesës dhe rregullimin e sistemit për periudhën kohore 10 vjeçare.

Plani i Adekuacisë së Gjenerimit përmban:

- Metodologjinë e vlerësimit të Adekuacisë së Gjenerimit;
- Parashikimin e ngarkesës;
- Parashikimin e kapaciteteve gjeneruese;
- Adekuacinë e gjenerimit; dhe
- Adekuacinë e sistemit.

1.4 Masat nxitëse për ndërtimin e kapaciteteve nga BRE-të

Sa i përket promovimit të gjenerimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, neni 14 i Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë kërkon nga të gjithë pjesëmarrësit në sektorin e energjisë kryerjen e detyrave në vijim:

- a. *Gjatë dispeçimit të energjisë së prodhuar, operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes duhet t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi, sipas kufizimeve të specifikuar për qëllime të sigurimit të sistemit në Kodin e Rrjetit dhe në rregullat e kodet e tjera.*

- b. *Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi bartësin e shpenzimeve të përcaktimeve teknike, siç janë lidhjet në rrjet dhe përforsimet e rrjeteve të tyre, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike që furnizojnë me energji elektrike të prodhuar nga burime të ripërtëritshme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla dorëzohen për miratim te Rregullatori dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë, sipas kriterëve objektive, transparente e jo-diskriminuese, veçanërisht duke i marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga lidhja e këtyre prodhuesve në sistem.*
- c. *Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike që përdor burime të ripërtëritshme të energjisë apo bashkëprodhim, e që dëshiron të lidhet në sistem, vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga lidhja, për të cilin vlerësim operatori i sistemit mund ta ngarkojë një pagesë e cila i pasqyron kostot e arsyeshme të tij.*
- d. *Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalimin e sistemeve, siç janë lidhja në rrjet dhe përforsimet, ndërmjet të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike që përfitojnë prej tyre. Këto rregulla parashtrihen për miratim te Rregullatori dhe ato duhet të jenë në përputhje me Strategjinë, si dhe me aktet e tjera nënligjore.*
- e. *Rregullatori siguron që tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes për lidhje dhe shfrytëzim të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të mos e diskriminojnë operatorin e energjisë elektrike me prejardhje nga burime të ripërtëritshme të energjisë, e posaçërisht operatorin me energjinë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtëritshme të energjisë në rajonet periferike dhe me dendësi të vogël të popullatës.*

Sipas kërkesave të nenit 16 paragrafi 1.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike, KOSTT e ka përpiluar dhe ZRRE e ka miratuar Metodologjinë e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit. Ky dokument është sajuar në bazë të kriterëve transparente dhe jodiskriminuese të cilat i përcaktojnë obligimet e të gjitha palëve. Ndërsa Metodologjia e Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Shpërndarjes është në proces të finalizimit dhe miratimit. Këto dokumente përmbajnë edhe provizionet për kyçjen e gjeneratorëve nga BRE në rrjetat përkatëse.

Sa i përket promovimit të burimeve të ripërtëritshme, MZHE ka miratuar caqet vjetore dhe afatgjata të detyrueshme deri në vitin 2020, për të cilat ZRRE ka miratuar tarifat stimuluese (*feed-in*) për erë, hidrocentrale të vogla, biomasë dhe solare/fotovoltaike. Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë (MBE) nga BRE-të do të jenë për periudhë 10-vjeçare për Hidrocentrale të vogla dhe Biomasa, ndërsa për gjeneratorët nga panelet solare/fotovoltaike dhe Turbinat e Erës kanë MBE 12 vjeçare.

ZRRE ka arritur në përfundim se mbështetja e investimeve në energjinë e ripërtëritshme përmes tarifave nxitëse ("Feed-in") tanimë nuk është e nevojshme në raport me disa vite më parë, marrë parasysh edhe zhvillimet në shumë vende evropiane dhe të rajonit, ku tarifa nxitëse ("Feed-in"), si masë dominuese tanimë përjashtohet nga skemat mbështetëse, duke u zëvendësuar me modele

të reja të cilat përafrojnë çmimet e energjisë nga BRE me ato të tregut, andaj në fund të vitit 2020, ZRRE ka vendosur që të ndërpritet aplikimi i Skemës Mbështetëse me tarifa Nxitëse ("Feed – in") për mbështetjen e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë (BRE). Në pajtim me detyrimet ligjore dhe në bashkëpunim me Institucionet e Republikës së Kosovës, ZRRE do të ndërmarr veprime për zhvillimin e projekteve nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë për caqet afatgjata përmes formave të ndryshme të ankandëve, në përzgjedhjen e përfitueseve nga format tjera përmes Tarifave Premium ose të ngjashme, konform praktikave më të mira në favor të interesit publik.

ZRRE ka vlerësuar edhe konkluzionet e takimit të 15 të Këshillit Ministror që kanë inkurajuar Palët Kontraktuese, ku bën pjesë edhe Republika e Kosovës, që të punojnë ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (SKE) dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në hartimin dhe zbatimin e procesit konkurrues, efikas dhe transparent për dhënien e skemave mbështetëse për burimet e ripërtrishme të energjisë.

ZRRE ka marr parasysh edhe fillimin e zbatimit të Projektin për zhvillimin e Ankandit për BRE-të financiar nga BERZH, i cili ka për detyrë hartimin e procedurave për implementimin e Ankandit për BRE-të dhe i cili pritet të fillojë të implementohet gjatë vitit 2021.

1.5 Masat e emergjencës në furnizimin e energjisë

Meqenëse sistemi energjetik i Kosovës është i modeluar për prodhimin e energjisë bazë, atëherë balancimi i sistemit mbetet ndër çështjet kyçe. Sigurimi i energjisë për periudhën e pikut, përveç prodhimit vendor bëhet edhe përmes importeve, ndërsa në rast të rënive të njësive gjeneruese kjo realizohet përmes importeve emergjente ose ndonjëherë edhe me aplikimin e reduktimeve si masë e fundit për të mbajtur sistemin në balancë.

Bazuar në ligjin për energji, neni 25, *Qeveria, si masë emergjente, mund të vendosë kufizime në furnizimin me energji për konsumatorët, ose të vendosë obligime të veçanta për ndërmarrjet e energjisë në këto raste:*

- ...
- *çfarëdo mungese të papritur ose afatgjate të kapacitetit prodhues energjetik ose kapacitetit të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë;*
- ...

Në kuadër të kësaj Qeveria mund:

- *të vendosë kufizime mbi aktivitetet komerciale që kanë të bëjnë me burime të caktuara të energjisë;*
- *të vendosë kushte të veçanta komerciale;*
- *të kufizojë tregtimin e energjisë ose të vendosë kushte të veçanta për tregtimin e energjisë;*
- *të detyrojë prodhimin e energjisë që do të ndodhë në objekte të saktësuara të prodhimit; dhe*

- të vendosë detyrime për furnizimin me energji për konsumatorë të caktuar, vetëm në pajtim me kriteret e parapërcaktuara dhe objektive të sajura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të miratuara nga Rregullatori.

Pas më shumë se një dekade të një procesi të gjatë, me 14 dhjetor 2020 hyri në fuqi Marrëveshja e Kyçjes ndërmjet KOSTT dhe operatorëve të sistemit të transmetimit (OST) nga Evropa Kontinentale, duke shënuar ditën e parë të funksionimit të KOSTT si një zonë e kontrollit ENTSO-E. Kosova përmbushi të gjitha kërkesat teknike dhe formale për t'u bërë një zonë e pavarur kontrolli në ENTSO-E. Në të njëjtën kohë në dhjetor 2020, u krijua një bllok i përbashkët kontrolli midis zonës së kontrollit të Shqipërisë dhe zonës së kontrollit të Kosovës. Për më tepër, linja 400 kV midis Kosovës dhe Shqipërisë e ndërtuar në 2016 u vendos më në fund në funksionim normal, duke kontribuar në shkëmbime më të mëdha ndërkufitare, duke përfshirë shkëmbimin e mundshëm ndërkufitar të rezervave. Sistemet energjetike të Kosovës dhe Shqipërisë janë sisteme plotësuese termike - hidrike, ku Kosova nuk ka ende njësi gjeneruese të brendshme fleksibile dhe të shpejta për të shërbyer si një kapacitet rezervë të sistemit, dhe Shqipëria ka njësi të tilla. Prandaj, është në dobi të ndërsjellë - si element i bashkimit të këtyre dy tregjeve - të përdoren kapacitetet e disponueshme të transmetimit ndërkufitar për shkëmbimin e kapaciteteve rezervë të sistemit energjetik.

Për rastet e dështimit të furnizuesit aktual, bazuar në legjislacionin në fuqi, ZRRE ka përcaktuar Furnizuesin e Mundësisë së Fundit i cili do të merr përgjegjësitë për furnizimin e konsumatorëve të cilët kanë mbetur pa furnizues.

Sipas Ligjit për energji elektrike, neni 41, furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të:

- furnizojë konsumatorët fundorë sipas nenit 39 të këtij Ligji derisa konsumatorët të zgjedhin furnizuesin sipas dëshirës, por jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë;
- faturtojë konsumatorët fundorë të përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji për energjinë elektrike të livruar, në pajtim me çmimet e furnizimit të garantuar, të miratuara nga Rregullatori në pajtim me metodologjinë e hartuar dhe miratuar nga Rregullatori;
- informojë konsumatorët fundorë për kushtet e furnizimit të garantuar, ndërprerjen e kontratës për furnizim të garantuar dhe të drejtën e tyre për zgjedhjen e lirë të furnizuesit të energjisë elektrike;
- dorëzojë tek konsumatori fundor kontratën e furnizimit të garantuar jo më vonë se tetë (8) ditë nga fillimi i furnizimit.



2. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Sektori i energjisë elektrike përbëhet nga gjenerimi, transmetimi, shpërndarja dhe furnizimi i konsumatorëve.

Gjenerimi; është kryesisht i bazuar në termocentrale me linjit (TC A dhe TC B), dhe HC Ujmani të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës 100 %, ndërsa HC dhe BRE tjera janë në pronësi private.

Transmetimi(KOSTT); është operator i vetëm i transmetimit dhe tregut dhe është 100 % në pronësi të Kuvendit të Kosovës. Operon me dy licenca të ndara, licencë për operim të sistemit të transmetimit dhe licencë për operim të tregut.

Shpërndarja (KEDS); është operatori i vetëm i shpërndarjes dhe është në pronësi private.

Furnizuesi (KESCO); është furnizues që ka licencë për furnizimin e konsumatorëve përfshirë konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal sipas Obligimit të Shërbimit Publik të përcaktuar nga Rregullatori. Gjithashtu KESCO është e përcaktuar nga ZRRE si Furnizues i Mundësisë së Fundit.

Furnizues tjerë; deri më tani janë të licencuar 8 operator ekonomik por ende nuk kanë filluar me operim komercial.

2.1 Tregu i energjisë elektrike

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë përfshinë tregtimin bilateral të energjisë elektrike dhe tregtimin për të balancuar sistemin e energjisë elektrike. Bazuar në legjislacionin në fuqi, prodhuesit e energjisë elektrike janë të obliguar t'iu ofrojnë kapacitetin e tyre në mënyrë transparente, jo diskriminuese dhe të bazuar në treg të gjithë konsumatorëve në tregje me shumicë dhe pakicë duke përfshirë edhe atyre me obligime të shërbimit publik.

Për shkak të fleksibilitetit të ulët të gjenerimit për t'iu përshtatur kërkesës si dhe për shkak të kërkesës së lartë në kohën e pikut, ndërsa të kërkesës mjaftë të ulët në periudhën e jo pikut, lind nevoja për importe gjegjësisht eksporte të energjisë elektrike. Nga gjithsej kërkesa për energji elektrike në nivel të vendit (përfshirë edhe humbjet në transmetim dhe shpërndarje), pjesa më e madhe mbulohet nga prodhimi (gjeneratorët) vendor, kurse pjesa tjetër mbulohet nga importet e energjisë elektrike.

Tabela më poshtë paraqet të dhënat bazë të sistemit, prej nga shihet se vendi ynë gjatë vitit 2019 ka qenë neto importues, ndërsa gjatë vitit 2020 ka qenë neto eksportuese.

Tab. 2.1 Të dhënat bazë të sistemit elektroenergjetik

	Të dhënat bazë të sistemit elektroenergjetik GWh	2019	2020
1	Prodhimi nga gjeneratorët në transmetim	5,650	6,187
2	Prodhimi nga gjeneratorët në shpërndarje	68	114
3	Importi	928	839
4	Gjithsej energjia në disponim	6,646	7,140
5	Eksporti	905	1,283
6	Net import/eksport	-24	444
7	Devijimet e sistemit (marrje nga sistemi)	-260	-316
8	Transiti	1,696	1,918
9	Kërkesa nacionale	6,001	6,167
10	Humbjet në transmetim	105	107
11	Konsumi i konsumatorëve në rrjetin e transmetimit	464	396
12	Konsumi LLOMAG	110	114
13	Ngarkimi në rrjetin e shpërndarjes	5,322	5,549
14	Humbjet në shpërndarje	1,378	1,409
15	Neto konsumi në shpërndarje	3,944	4,140

Liberalizimi i tregut është proces që është intensifikuar me miratimin e ligjeve të reja të energjisë nga Kuvendi i Kosovës. Bazuar në kërkesat ligjore dhe ato të Sekretariatit të komunitetit të Energjisë (SKE) ky proces zgjerohet edhe me formimin e tregjeve PX (shkëmbimi i energjisë - APEX) dhe bashkimin e tregjeve (market coupling), në mes Kosovës dhe Shqipërisë. Tregu i përbashkët Kosovë - Shqipëri do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për dy vendet tona, duke marrë në konsideratë faktin se dy vendet tona kanë sisteme komplementare të prodhimit të energjisë elektrike.

Në mënyrë që të vijohet me integrimin e tregjeve ndërmjet vendeve tona, është e nevojshme vijimi i harmonizimit të legjislacionit dhe të akteve rregullatorë sekondarë në mënyrë që të eliminohen pengesat që mund të dalin në këtë drejtim. Në këtë kuadër me ndihmën e USAID, grupet e punës tashmë të ngritura me përbërjen e Ministrive, Rregullatorëve dhe Operatorëve të Sistemit janë duke punuar në këtë drejtim. Po ashtu operimi i të dy sistemeve, si një zonë e vetme kontrolli sipas marrëveshjes së nënshkruar në fund të vitit 2019 ndërmjet dy operatorëve të sistemit, me miratim dhe të të dy rregullatorëve, është një hap i rëndësishëm në drejtim të bashkimit të tregjeve dhe optimizimit të kapaciteteve të interkoneksionit. Grupet e punës të ngritura tashmë midis TSO-ve, Rregullatorëve dhe Bursave të Energjisë Elektrike janë duke vijuar punën për rishikimin e legjislacionit primar dhe sekondar për mundësimin e bashkimit të këtyre tregjeve si dhe hapave që duhen ndërmarrë për funksionimin e tij.

ZRRE ka miratuar Rregullën për transparencë dhe integritet të tregut me shumicë të energjisë (REMIT), e cila është transpozim i rregullores Nr.1227/2011 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, vendos theksin në rritjen e transparencës dhe ruajtjen e integritetit të tregut me shumicë të energjisë elektrike si në vend ashtu dhe në rajon.

2.2 Monitorimi i sigurisë së furnizimit

Rregullatori është përgjegjës për monitorimin e operimit të tregjeve të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojë funksionimin efikas të tyre, si dhe të identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për furnizim të sigurt të konsumatorëve.

Energjia e tregtuar nga burimet vendore dhe importi është shfrytëzuar për mbulimin e kërkesës përfshirë konsumin, humbjet dhe balancimin e sistemit. Duhet theksuar se tregtimi i energjisë elektrike bëhet duke respektuar procedurën për tregtimin e energjisë elektrike, e cila përcakton parimet e përgjithshme të blerjes dhe shitjes së energjisë elektrike.

ZRRE në vazhdimësi ndërmerrë aktivitete të monitorimit të ndërmarrjeve të energjisë lidhur me sigurinë e furnizimit, por edhe nëse ndërmarrjet janë duke vepruar në pajtueshmëri me kushtet e licencës, zbatimin e rregullave, akteve individuale dhe vendimeve të lëshuara nga rregullatori apo legjislacioni tjetër në fuqi.

2.3 Sistemi elektroenergjetik

2.3.1 Sistemi i transmetimit

Transmetimi i energjisë elektrike është i një rëndësie të veçantë për sigurinë e furnizimit dhe mbarëvajtjen e tërë sistemit elektroenergjetik. Rrjeti i transmetimit në Kosovë, operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe tregut - KOSTT që është përgjegjës për sigurinë dhe besueshmërinë e operimit të sistemit elektroenergjetik. Rrjeti i transmetimit ka kapacitete të mjaftueshme për të përballuar kërkesën vendore dhe rrjedhat e energjisë në sistem.

Rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës është i ndërlidhur mirë me sistemin rajonal dhe të Evropës përmes linjave interkonektive me:

- Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë – me linja 400 kV;
- Shqipërinë dhe Serbinë – me linja 220 kV; dhe
- Serbinë - me dy linja 110 kV.

Linja interkonektive 400 kV NS Kosovë B – NS Kashar (Tiranë) e finalizuar në vitin 2016 është futur në operim të rregullt në dhjetor 2020 me fillimin e zbatimit të marrëveshjes për Rregullimin Sekondar Frekuencë/Fuqi në mes të KOSTT dhe OST të Shqipërisë për operim si zonë/bllok rregullues në kuadër të ENTSO-E.

Në rrjetin e transmetimit gjatë viteve 2000 – 2020 janë realizuar investime të mjaftueshme me qëllim të avancimit të kapaciteteve të rrjetit të transmetimit. Këto investime kanë shtuar sigurinë e furnizimit dhe kanë rezultuar me zbritje të dukshme të humbjeve në transmetim. Në saje të investimeve të bëra, rrjeti i transmetimit të sistemit elektroenergjetik të Kosovës plotëson nevojat vendore të transmetimit si dhe kriterin N-1, përveç linjës Therandë – Rahovec e cila mbetet me furnizim radial.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur kapacitetet transformuese dhe linjat e rrjetit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit:

Tab. 2.2 Linjat në rrjetin e transmetimit

Tensioni (kV)	Pronari	Gjatësia (km)
400	KOSTT	279.5
220	KOSTT	238.5
110	KOSTT	892.5
Gjithsej		1,410.5

Tab. 2.3 Nënstacionet në rrjetin e transmetimit

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia (MVA)
400/220	KOSTT	1	3	1200
400/110	KOSTT	2	4	1200
220/110	KOSTT	3	9	1350
220/35	Feronikel	1	2	320
220/35/10(20) (Besiana)	KOSTT	1	1	40
220/10(20) (Besiana)	KOSTT	-	1	40
220/10(20)	KOSTT	1	2	80
110/35/10(20)	KOSTT	6	7	277.5
110/35/6.3	Trepça	1	2	126
110/6.3	Trepça	-	1	31.5
110/35	Ujmani	1	1	20
110/6.3	Sharri	1	2	40
110/10(20)	KOSTT	16	26	949.5
110/35	KOSTT	11	19	641
110/10	KOSTT	6	8	252
35/110 (Deçan)	Kelkos	-	1	40
Gjithsej		51	89	6,608

Skema më poshtë paraqet informata bazë mbi numrin e nënstacioneve (NS), transformatorëve (TR) dhe fuqinë transformuese (VA), gjatësinë e linjave, si dhe centralet kyçura në nivelin përkatës të tensionit.




Fig. 2.1 Të dhënat bazë të rrjetit të transmetimit

Rrjedhat e energjisë elektrike

Kosova ka pozitë të favorshme si nyje rajonale, dhe përmes rrjetit të saj të transmetimit rrjedhin sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike. Këto rrjedha për secilën linjë interkonektive në Kosovë janë paraqitur në figurën 2.2. Situata në rajon si në vitet paraprake në përgjithësi karakterizohet me mungesë të energjisë elektrike, në veçanti në pjesën jugore; pra, energjia elektrike kryesisht rrjedh nga veriu në drejtim të jugut.

Kosova është vend me nivel të lartë të transitit të energjisë elektrike, ku raporti mes konsumit dhe transitit është deri në 31% (raporti i transitit). Kjo fuqizon pozitën e sistemit të transmetimit, por edhe i shton humbjet në transmetim dhe shpie te kongjestioni në rrjet. Për të menaxhuar transitin rajonal, shfrytëzohet mekanizmi për kompensimin e transitit mes OST-ve (mekanizmi ITC). Kosova merr pjesë në ITC Mekanizmin për kalkulimin e kompensimit për shpenzimet e transitit dhe obligimet për importet dhe eksportet.

Me fillimin e operimit si Zonë Rregulluese e pavarur në kuadër të Evropës Kontinentale, Kosova ka filluar alokimin e kapaciteteve ndërkufitare dhe menaxhimin e kongjestionëve që nënkupton mbledhjen e të hyrave nga tregtimet ndërkufitare.




Fig. 2.2. Rrjedha e energjisë elektrike nëpër linjat ndërkufitare 2020

Humbjet e energjisë elektrike në transmetim

Gjatë viteve të fundit vërehet një stabilizim në lakoren e humbjeve të energjisë elektrike në transmetim. Gjatë vitit 2019, humbjet në transmetim kanë qenë 105 GWh, ose 1.76% ndaj konsumit të gjithmbarshëm, ndërsa në vitin 2020 këto humbje ishin 107 GWh, ose 1.74% ndaj konsumit bruto në Kosovë. Humbjet në transmetim gjithashtu përfshijnë humbjet e shkaktuara nga transiti. Humbjet në përqindje ndaj tërë energjisë së futur në rrjetin e transmetimit në vitin 2020 janë 1.18%.

Figura në vijim paraqet lakoren e humbjeve në transmetim gjatë viteve të fundit.




Fig. 2.3. Humbjet në transmetim 2010-2020

Investimet e realizuara dhe të pritura në sistemin e transmetimit

Gjatë viteve të fundit janë realizuar investime me qëllim të përforcimit të sistemit që kanë ndikuar në furnizim më të sigurt dhe cilësor të konsumatorëve. Këto investime kanë shtuar sigurinë e furnizimit dhe kanë rezultuar me zbritje të dukshme të humbjeve.

Investimet e realizuara në sistemin e transmetimit 2019 dhe 2020

- 110/10(20) kV – NS Prishtina 6 (Dardania) dhe dy fusha 110 kV HIS në NS Prishtina 4;
- 220/10(20) kV – NS Drenasi 2;
- 110/10(20) kV – NS Mitrovica 2 (Ilirida);
- Linja 110 kV e njëfishtë ajrore NS Rahoveci – NS Theranda ka përfunduar;
- Linja 110 kV e dyfishtë dhe ajo kabllorike, NS Fushë Kosova pritet të përfundoj në Q2 2021;
- Renovimi i ndërtesave Komanduese në: NS Deçani, NS Lipjani, NS Burim, NS Viti, NS Prishtina 3 , NS Prizreni 3, NS Gjakova 2, NS Besiana dhe NS Vitia, NS Gjakova 1;
- NS Prishtina 4- Rehabilitimi i Harxhimit vetanak, Ormaneve AC/DC dhe Kabllorve;
- Rehabilitimi i kthinave AC 400V;
- Përfshirja e nënstacioneve të reja në sistemin SCADA/EMS në QND dhe QEND.

Disa nga këto investime ende nuk kanë përfunduar, por janë para përfundimit.

Investimet që priten në kapacitetet e reja të transmetimit

Rrjeti i transmetimit është në gjendje të mirë, pas investimeve të bëra në infrastrukturë megjithëkëtë nevojiten investime të vazhdueshme duke pasur parasysh sigurinë e furnizimit që përfshinë rritjen e kapacitetit transmetues, përforcimin e rrjetit të transmetimit, ri-vitalizmin e rrjetit, përkrahjen e ngarkesës, mbështetjen e operimit të sistemit të transmetimit etj.



Gjatë viteve të ardhshme pritet të investohet në projektet që do të ndikojnë në sigurinë e furnizimit për konsumatorë:

Përforcim i rrjetit të transmetimit

- Reaktori variabil 100MVA, 400 kV në NS Ferizaj 2;
- Transformatori I dytë 40MVA në NS 110/10(20) – Klinë;
- Ri-vitalizimi i linjës 110 kV: NS Prizreni 1 - NS Prizreni 3;
- Linja e re 110 kV NS Prizren 1- NS Prizren 2;
- Transformatori I dytë 40 MVA në NS 110/10(20)kV Gjilani 5;
- Zëvendësim i transformatorit në NS 110/10kV Deçani (40MVA);
- Zëvendësim i transformatorit në NS 110/10kV Gjakova 1 (40MVA);
- Zëvendësim i transformatorit në NS 110/10kV Therandë (40MVA);
- Zëvendësim transformatori ne NS Ferizaj 1, (40MVA);
- Ri-ndertim i linjës 110 kV: NS Palaj A- NS Ilirida - NS Vallaq (segmenti 150mm²);
- Zëvendësim transformatori ne NS Prizreni 1 dhe Peja 1 (40MVA);
- Linja e re kabllorike 110 kV NS Prishtina 2- NS Prishtina 4;
- Ri-vitalizimi i linjës 110 kV:L116 (155/2) Vallaq- kufi;
- Zëvendësim transformatori ne NS Gjakova 1 Gjilani 1 dhe NS Vitia (40MVA);
- Ri-vitalizimi i linjës 110 kV:L127 NS Bibaj -NS Kastriot (NS i ri);
- Ri-vitalizimi i linjës 110 kV:L106 NS Ferizaj 2- NS Sharr;
- NS NASHEC, 400/220/110 kV me linjën ndërlidhëse 400 kV;

Përkrahja e ngarkesës

- NS 110/35/10(20) kV - Fushë Kosova;
- NS 110/10(20) kV Kastrioti (Ferizaj 3) me linjat transmetuese 110 kV;
- NS 220/10(20) kVMalisheva me linjat transmetuese 220kV;
- NS 110/10(20) kV Dragashi me linjat transmetuese 110kV;

Rivitalizimi i nënstacioneve të sistemit të transmetimit

- Rivitalizimi i pajisjeve TL në NS Klinë dhe NS Burim;
- Ri-vitalizimi i pajisjeve të TL ne NS Vallaq;

Mbështetja e operimit të sistemit të transmetimit

- Sinjalizimet te linjat ajrore për sigurinë e aviacionit;
- Sendërtimi i SCADA/EMS;
- Migrimi drejt sistemeve të avancuara telekomunikuese;

Përkrahja e gjenerimit për kyçje

- PEE "Selaci 1, 2 dhe 3", 105 MW, 30 turbina me kapacitet 3.45 MW;

- HC “Lepenci”, 9.92 MW;
- PEE “Koznica”, 34.5 MW, 10 turbina me kapacitet 3.45 MW;
- PEE Hidrocentrali Reverzibil 250 MW;
- PEE ÇIÇAVICA 116 MW;
- Instalimi i paneleve solare dhe efiçienca e energjisë në nënstacionet e KOSTT.

2.3.2 Rrjeti i shpërndarjes

Gjatë viteve të fundit në rrjetin e shpërndarjes ka pasur investime, megjithatë ato kanë qenë të pamjaftueshme për të siguruar furnizim cilësor dhe të qëndrueshëm për konsumatorët.

Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 20 kV, 10 kV, 6 kV dhe 0.4 kV, si dhe nënstacionet përkatëse të nivelit 35/xx kV/kV e më ulët.

Investimet e vazhdueshme kanë pasur për qëllim përforcimin dhe zgjerimin e kapaciteteve transformuese dhe linjave përkatëse të sistemit të shpërndarjes, si rezultat i shtimit të konsumit vit pas viti. Të dhënat bazike të nënstacioneve dhe linjave të tensioneve të ndryshme, si dhe gjatësia e sistemit përkatës të shpërndarjes janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab.2.4 Numri i nënstacioneve të OSSH sipas nivelit të tensionit

Transformimi (kV/kV)	Pronari	Nr. i NS	Nr. i TR	Fuqia e instaluar (MVA)
35/10	KEDS	44	94	662
35/10	Privat	11	15	68
35/20	KEDS	2	5	41
35/6 kV	Privat	5	8	43
35/0.4kV	Privat	17	23	22
10(20)/0.4	KEDS	2,511	2,606	1,329
10(20)/0.4	Privat	2,582	2,592	1,254
10/20	KEDS	1	1	109
10/0.4	KEDS	2,865	2,865	868
10/0.4	Privat	1,247	1,253	606
6(3)/0.4	KEDS	66	66	13
6/0.4	Privat	1	1	1
Gjithsej		9,353	9,530	5,017

Tab.2.5 Të dhënat themelore për linjat e OSSH

Tensioni (kV)	Pronari	Rrjeti ajror (km)	Rrjeti kabllor (km)	Gjithsej (km)
35 kV	KEDS	482	137	619
10(20) kV	KEDS	1,536	521	2,057
10 kV	KEDS	4,165	904	5,069
6 kV	KEDS	42	8	50
3 kV	KEDS	4	1	5
0.4 kV	KEDS	17,484	2,561	20,045
Gjithsej		23,713	4,132	27,845

Humbjet në shpërndarje

Humbjet e përgjithshme në shpërndarje janë shumë të larta. Këto humbje ndahen në humbje teknike, dhe humbje komerciale të cilat shfaqen si rezultat i shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Figura e më poshtme tregon trendin e ndryshimit të humbjeve teknike, komerciale dhe humbjeve të përgjithshme në rrjetin e shpërndarjes gjatë viteve 2010 – 2020.




Fig.2.4. Humbjet në shpërndarje 2010-2020

Investimet e realizuara dhe të pritura në sistemin e shpërndarjes

Gjatë viteve të kaluara janë realizuar investime në rrjetin e shpërndarjes që kryesisht kanë qenë investime emergjente dhe të fokusuara në rrjetin e tensionit të ultë dhe transformatorët e mbingarkuar, pa i neglizhuar edhe investimet e tjera të nevojshme. Këto investime kanë qenë:

- Investimet në ngritjen e kapaciteteve në nënstacionet e tensionit të mesëm (TM);
- Investimet në Largpërçuesit (LP) e tensionit të mesëm (TM);
- Investimet në përmirësimin e rrjetit të tensionit të ulët (TU);
- Investimet në kalimin nga tensioni i mesëm 35 dhe/ose 10 kV në 20 kV;
- Investimet në mirëmbajtje;
- Investimet në pikën matëse; dhe
- Investimet në SCADA.

Investimet që priten në kapacitetet e reja të shpërndarjes

Objektivat kryesore të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në investime janë të fokusuara në zvogëlimin e humbjeve teknike dhe komerciale, sigurimin e qëndrueshmërisë së furnizimit kualitativ të energjisë elektrike duke përkrahur edhe rritjen e ngarkesës, si dhe rehabilitimin dhe modernizimin i rrjetit elektrik.

Në rrjetin e shpërndarjes do të vazhdojnë investimet në ngritjen e kapaciteteve në nënstationet e tensionit të mesëm (TM); largpërçuesit (LP) e tensionit të mesëm dhe të ulët; përmirësimin e rrjetit të tensionit të ulët; mirëmbajtje; pikën matëse; dhe SCADA sistemin. Këto investime konsistojnë në:

- **Projektet e Master Planit**, të cilat kanë ndikim të madh në qëndrueshmërinë dhe cilësinë e furnizimit. Në total, ato përbëjnë 147 projekte në të gjitha 7 distriktet e Kosovës.
- **Projektet e kalimit në nivelin 20 kV**, të cilat kanë ndikim të madh në zvogëlimin e humbjeve teknike, e njëkohësisht është edhe një kërkesë për t'i përmbushur standardet e BE-së. Në total në këtë periudhë (2018-2022) ato përbëjnë 35 projekte në të gjitha 7 distriktet e Kosovës.
- **Projektet për zgjerimin e rrjetit**, të cilat kanë rrjedhur nga kërkesa e re për konsum dhe të cilat do të ndihmojnë në reduktimin e rënies së tensionit, humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit. Ato përbëjnë gjithsej 446 projekte në të gjitha 7 distriktet e Kosovës.
- **Projektet e Përforcimit të rrjetit**, kryesisht janë të orientuara në rrjetin e tensionit të ulët, dhe tentojnë të përmirësojnë cilësinë e furnizimit dhe zvogëlimin e humbjeve. Në total, ato përbëjnë 437 projekte në të gjitha 7 distriktet e Kosovës.
- **Njehsorët**, përfshijnë projektet që janë si rezultat i kërkesave ligjore, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të shpërndarjes dhe të cilat do të ketë ndikim në të gjithë konsumatorët.
- **Projektet e Rrjetit të Mençur (Smart Grid)**, kanë ndikim në modernizimin e sistemit, në përputhje me rrjetin e sistemit të transmisionit, dhe zvogëlimin e SAIDI, SAIFI dhe / ose Energjisë së pa-furnizuar (ENS). Ato përbëjnë gjithsej 63 projekte.
- **Makineritë**, janë domosdoshmëri që sigurojnë vazhdimësinë e biznesit, dhe të cilat me kalimin e kohës duhet të ndërrohen për shkak të kostos së tyre të lartë të mirëmbajtjes dhe / ose dëmeve të pa riparuar.
- **Shërbimet mbështetëse**, të cilat përfaqësojnë shërbime, të tilla si IT (Teknologji Informative), e të cilat janë edhe të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e biznesit por njëherazi janë edhe projektet sipas kërkesave ligjore.

ZRRE është në përfundim të analizimit dhe aprovimit të planit zhvillimor dhjetë vjeçar të operatorit të sistemit të shpërndarjes, andaj pas aprovimit të këtij plani zhvillimor projektet investive për gjatë viteve do të rriten në rrjetin e shpërndarjes.

2.3.3 Kualiteti i furnizimit

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike janë element i rëndësishëm i rregullimit të sektorit të energjisë. Për këtë qëllim Rregullatori ka zhvilluar Rregullën për standardet e cilësisë të shërbimit të energjisë elektrike e cila është aprovuar në vitin 2019.

Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike definoohen dhe monitorohen sipas fushave në vijim:

- Kontinuiteti i furnizimit;
- Cilësia e tensionit; dhe
- Cilësia komerciale.

Kontinuiteti i furnizimit është i ndërlidhur me disponueshmërinë e sistemit energjetik, përkatësisht paraqet numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve për çdo konsumator brenda një viti, si dhe energjinë e pa furnizuar. Kontinuiteti i furnizimit matet me anë të indekseve:

- SAIDI - Indeksi mesatar i kohëzgjatjes së ndërprerjeve në sistem;
- SAIFI - Indeksi mesatar i frekuencës së ndërprerjeve në sistem; dhe
- ENS - Energjia e pafurnizuar,
- AIT - Koha mesatare e ndërprerjes.

Figura e më poshtme tregon indeksat AIT (në orë) dhe ENS (GWh) për vitin 2020 dhe ENS (GWh) për vitet 2015 - 2020 për rrjetin e transmetimit dhe indeksat SAIDI (në orë), SAIFI (numri i ndërprerjeve) dhe ENS (GWh) për vitet 2015 - 2020 rrjetin e shpërndarjes.




Fig. 2.5 Indikatorët AIT dhe ENS për OST për periudhën 2015-2020




Fig. 2.6 Indeksi matës ENS për OST për periudhën 2015 - 2020



Fig. 2.7 Indikatorët SAIDI, SAIFI dhe ENS për OSSH për periudhën 2011-2020

Cilësia e tensionit është e ndërlidhur me aspektin teknik të sistemit të energjisë elektrike dhe krahasohet ndaj tensionit nominal, që kryesisht gjatë kësaj periudhe është monitoruar përmes regjistrimit të ankesave të konsumatorëve lidhur me cilësinë e tensionit. Standardet e cilësisë së tensionit janë të përcaktuara në Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, në Kodin e shpërndarjes dhe Kodin e matjes së shpërndarjes.



Cilësia komerciale përcakton efikasitetin dhe saktësinë e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve. Të dhënat për identifikimin e cilësisë komerciale, ndahen në tri kategori, që janë:

- Kyçjet/lidhjet e reja;
- Pëlqime energjetike; dhe
- Ankesat e konsumatorëve

2.4 Gjenerimi i energjisë elektrike

Kosova posedon parakushtet për prodhimin e energjisë elektrike, jo vetëm për të mbuluar nevojat e veta por edhe për të eksportuar. Sistemi elektroenergjetik i Kosovës është i dizajnuar kryesisht për të prodhuar energji elektrike bazë nga burimet konvencionale me linjit, dhe mbulimi i ngarkesave maksimale dhe balancimi i sistemit mbetet sfidë e madhe për të gjithë pjesëmarrësit në sektor.

Edhe pse njësitë gjeneruese me linjit të cilat janë në operim janë të vjetruara, gjatë viteve të fundit kanë pasur rritje të prodhimit, megjithatë prodhimi vendor nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar konsumin në rritje të vazhdueshme, andaj, një pjesë e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë mbulohet nga importi gjatë periudhave të ndryshme kohore, sidomos në kohën e pikut. Me gjithë këtë në periudha të caktuara, posaçërisht gjatë natës - në tarifën e ulët, paraqiten teprica të energjisë elektrike të cilat eksportohen.

2.4.1 Kapacitete gjeneruese dhe gjenerimi i energjisë elektrike në vitet paraprake

Kapacitetet e gjenerimit të energjisë elektrike në Kosovë kryesisht dominohen nga termocentralet me linjit Kosova A dhe Kosova B. Këto dy termocentralet bashkërisht kanë kapacitet të instaluar të përgjithshëm prej 1,478 MW. Për shkak të vjetërsisë dhe mos operimit të dy njësive të TC Kosova A, kapaciteti në dispozicion i të dy TC-ve është mjaft më i ulët se sa kapaciteti i instaluar. Së bashku, kapaciteti i gjithmbarshëm në dispozicion i njësive të këtyre termocentraleve arrin rreth 960MW.

Aktualisht, gjenerimi i energjisë elektrike nga termocentralet mbulon rreth 94% të gjenerimit të përgjithshëm në Kosovë. Përveç gjenerimit nga termocentralet, gjenerimi përkrahet edhe nga hidrocentralet: HC Ujmani me kapacitet të instaluar prej 35 MW, kaskada e lumit Lumbardhë me kapacitet rreth 32 MW, Centrali me Turbina të Erës WIND PARK-KITKA me kapacitet rreth 32.4 MW, dhe WIND PARK SELAC 1,2 dhe 3 me kapacitet rreth 105 MW si dhe Hidrocentralet e vogla të kyçura në sistemin e shpërndarjes me kapacitet të instaluar 68.45 MW.

Tab.2.6 Kapacitetet e gjenerimit të energjisë elektrike

Njësitë prodhuese	Kapaciteti i njësive (MW)			Futja në operim
	Instaluar	Neto	Min/max	
TC Kosova A1	65	Nuk operon		1962
TC Kosova A2	125	Nuk operon		1964
TC Kosova A3	200	144	100-130	1970
TC Kosova A4	200	144	100-130	1974
TC Kosova A5	210	144	100-135	1975
TC Kosova A	610	432		
TC Kosova B1	339	264	180-260	1983
TC Kosova B2	339	264	180-260	1984
TC Kosova B	678	528		
HC Ujmani	35.00	32.00		1983
HC Lumbardhi I	8.08	8.00		(1957) 2006
HC Dikanci	4.02	3.34		(1957) 2013
HC Radavci	1.00	0.90		(1934) 2010
HC Burimi	0.95	0.85		(1948) 2011
Lumbardhi II	6.20	6.20		2020
Gjithsej HC (jasht skemës mbështetëse)	55.25	51.29		
EGU Belaja	8.06	8.06		2016
EGU Deçani	9.81	9.81		2016
HC Hydroline-Albaniku III	4.27	4.27		2016
HC Brod II	4.80	4.80		2015
HC Restelica 1&2	2.28	2.28		2016
HC Brodi III	4.70	4.70		2016
HC Brezovica	2.10	2.10		2017
HC Orqusha	4.00	4.00		2019
HC Lepenci 3	10.00	10.00		2019
HC Dilli com	0.31	0.31		2020
HC Hidroline-Albaniku II	3.55	3.55		2020
HC ECO Energji	1.00	1.00		2020
Wind Power	1.35	1.35		2010
Air Energy-Kitka	32.40	32.40		2018
PV LedLight Technology	0.10	0.10		2015
PV ONIX SPA	0.50	0.50		2016
PV Birra Peja	3.00	3.00		2018
PV Frigo Food Kosova	3.00	3.00		2018
PV Eling	0.40	0.40		2019
PV SGE	3.00	3.00		2019
Gjithsej BRE (në skemën mbështetëse)	98.63	98.63		
Gjithsej	1,441.88	1,109.92		

Termocentrali Kosova A ka pesë njësi të cilat janë ndërtuar gjatë viteve të 60-ta dhe 70-ta të shekullit të kaluar. Aktualisht funksionojnë njësitë A3, A4 dhe A5. Njësitë A1 dhe A2 nuk janë në funksion për disa vite. Disponueshmëria e njësive të Kosovës A është rreth 50-60%.

Termocentrali Kosova B përbëhet nga dy njësi me djegie linjiti me kapacitet të instaluar të gjenerimit prej 2x339 MVA. Mes viteve 2000 dhe 2002 janë realizuar projekte të ndryshme për rehabilitimin e këtyre blloqeve. Qëllimi i projekteve të caktuara rehabilituese ka qenë ngritja e nivelit të performancës së TC Kosovës B për të shtuar disponueshmërinë dhe karakteristikat kontrolluese. Termocentrali Kosova B sot vepron me efikasitet më të ulët - me kapacitet prej rreth 310MW për njësi (në prag rreth 265MW). Njësitë e termocentralit Kosova B së shpejti do të arrijnë fundin e jetëgjatësisë së paraparë të tyre, andaj investime dhe masa të theksuara rehabilitimi janë planifikuar të realizohen gjatë viteve 2023/2024 për t'i sjellë këto dy njësi në nivelin e standardeve që kërkohen për operim, e me këtë arrihen edhe nivel i standardeve mjedisore të kërkuara dhe për t'ua zgjatur jetëgjatësinë e tyre, përtej vitit 2039.

Për shkak të mirëmbajtjes më të mirë të kapaciteteve gjeneruese, investimeve të mëdha në riparimin e njësive gjeneruese, dhe prodhimit të sasive të mjaftueshme të thëngjillit, prodhimi i energjisë elektrike ka shënuar rritje gjatë viteve.

Diagrami në vijim paraqet gjenerimin e gjithmbarshëm në Kosovë gjatë viteve 2010-2020, ku vërehet një rritje e vazhdueshme gjatë vitin 2020.




Fig.2.8. Gjenerimi i gjithmbarshëm 2010-2020

2.4.2 Operimi i njësive gjeneruese

Operimi i njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B gjatë vitit 2017 dhe 2018 ka qenë i përafërt me parashikimet në bilancet energjetike, si për orët në operim po ashtu edhe për energjinë e dhënë në sistem. Numri i ndaljeve nga operimi i njësive gjeneruese me linjit në vitin 2020 ka qenë i njëjtë krahasuar me vitin 2019.

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura llojet e ndaljeve të termocentraleve për vitin 2019.

Tab.2.7 Ndalesat e njësive gjeneruese 2019

2019	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	3	3	3	2	1
Ndalesat e paplanifikuara	4	5	1	8	7
Rëniet	0	0	2	2	7
Gjithsej ndalesa	7	8	6	12	15
Orë pune	3,271	6,262	6,802	7,652	5,275

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura llojet e ndaljeve të termocentraleve për vitin 2020.

Tab. 2.8 Ndalesat e njësive gjeneruese 2020

2020	TC Kosova A			TC Kosova B	
	A3	A4	A5	B1	B2
Ndalesat e planifikuara	1	3	2	2	1
Ndalesat e paplanifikuara	8	3	3	1	8
Rëniet	3	1	1	3	8
Gjithsej ndalesa	12	7	6	6	17
Orë pune	3,609	7,190	5,598	7,660	7,716

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2019 dhe 2020 orët e operimit të njësive gjeneruese të TC Kosova A dhe TC Kosova B kanë qenë më të ulëta se planifikimi, mirëpo karakteristike është se në vitin 2019 njësia A3 ka punuar vetëm 37% të vitit, ndërsa njësia B1 në vitin 2020 ka punuar vetëm 87% të vitit, derisa njësia B2 ka punuar 88% të vitit. Numri i orëve në operim i njësisë B2 në vitin 2018 është më i lartë madje se në vitet e para të operimit të kësaj njësie.

2.4.3 Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

Direktivat Evropiane dhe obligimet që dalin nga TKE definojnë kërkesat lidhur me BRE-të. Këto burime zënë vend të rëndësishëm në furnizimin e konsumatorëve me energji dhe duhet të merren në konsideratë gjatëparashikimittë investimeve në sektorin e energjisë. Edhe ligjet për sektorin e energjisë në Kosovë përkrahin investimet për kapacitetet gjeneruese nga BRE-të.

Kriteret për investime në BRE duhet të marrin parasysh caqet e përcaktuara nga MZHE, nivelin e përballueshmërisë së konsumatorëve, stabilitetin e sistemit dhe ndikimin e tyre në balancimin e sistemit. Në bazë të caqeve afatgjata të Strategjisë së Energjisë së Kosovës, politikave qeveritare, d.m.th. Udhëzimet Administrative nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 mbi “Caqet e Ripërtërishme të Energjisë”, “Studimit të parafizibilitetit për identifikimin e burimeve të ujit për hidrocentrale të vogla në Kosovë”, si dhe obligimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore në fushën e kapaciteteve të reja të gjenerimit nga burimet e ripërtërishme, ZRRE e ka të kompletuar legjislacionin sekondar për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Një ndër veprimtaritë e rëndësishme të ZRRE-së është lëshimi i autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike përfshirë gjenerimin që shfrytëzon burime e ripërtëritshme të energjisë, në pajtim me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja që është miratuar nga ZRRE.

ZRRE ka shqyrtuar aplikacionet/kërkesat e pranuar për autorizimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja të gjenerimit, në pajtim me ligjet e sektorit të energjisë dhe rregulloret relevante, duke siguruar që aplikacionet në fjalë të shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese. Gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, ZRRE ka marrë në konsideratë kriteret relevante që është dashur të plotësohen nga aplikuesit, në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Rregullën për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020 ZRRE ka lëshuar 22 autorizime preliminare për zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga burimet solare, të cilat janë konsideruar si aplikacione “në pritje”, me kapacitet të instaluar prej 66 MW.

Gjatë kësaj periudhe raportuese ZRRE ka lëshuar 2 autorizim final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës me kapacitet të instaluar prej 11 MW dhe nga Biomasa me kapacitet prej 1.2 MW (Ngrohtorja e Gjakovës).

Nga autorizimet finale të lartpërmenduar 9 projekte janë hyrë në operim komercial prej tyre: centralet solare Solar Green Energy, Eling dhe hidrocentralet HC Orqusha, Lepenci 3, Lumbardhi II dhe HC Brodi 3, HC Bresana, HC Albaniku II dhe HC Binqa me një kapacitet total të instaluar prej 33.16 MW, ndërsa centralet tjera janë në ndërtim e sipër dhe në faza të ndryshme të ndërtimit sipas afateve të autorizimeve.

Projektet të cilat janë duke u ndërtuar sipas planit dinamik të realizimit dhe sipas afateve ligjore, janë katër (4) projekte, nga Turbinat e Erës ku 103.4 MW me gjithsej njëzeteshtatë (27) turbina, në Parkun e Erës në Bajgora të Komunës së Mitrovicës, dhe projekti Parku i Erës Budakova me kapacitet prej 11 MW me gjithsej tri (3) turbina janë duke u ndërtuar në Budakovë të Suharekës. Poashtu në proces të ndërtimit janë edhe disa projekte të vogla nga hidrocentralet ku sipas dinamikës së punimeve priten të realizohen gjatë vitit 2021, si dhe projekti nga Biomasa me kapacitet prej 1.2 MW energji elektrike dhe 15 MW energji termike e cila do të realizohet nga NP Ngrohtorja e Qytetit – Gjakova, projekt i financuar nga Komisionin Europian.

Poashtu gjatë kësaj periudhe janë pranuar edhe disa projekte për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, të cilat janë në faza të ndryshme të shqyrtimit, ku janë tri projekte Hidrocentrali DRINI PSHP – REVERZIBIL me një kapacitet prej 250 MW, i cili është i dedikuar për rezerva të energjisë, një projekt nga Biomasa me një kapacitet prej 5.2 MW në Komunën e Ferizajt dhe Lepenci 1 me një kapacitet prej 9.98 MW.

Gjithashtu janë trajtuar edhe kërkesat/aplikacionet për gjeneratorët për marrjen e statusit të konsumatorit prodhues për vetë-konsum, të cilat pas plotësimit të kërkesave ligjore në pajtim me Rregullën e Autorizimit dhe Skemën mbështetëse, janë lejuar për të vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, kryesisht nëpër kulmet e objekteve, ku janë trajtuar rreth 57 aplikime me një kapacitet të instaluar prej 1,736.4 kW.

2.5 Kërkesa për energji elektrike dhe ngarkesa maksimale

Kërkesa për energji elektrike ka pasur rritje të vazhdueshme deri në vitin 2010, ndërsa nga viti 2010 ka një stabilizim të konsumit.

Më poshtë është paraqitur kërkesa e gjithmbarshme gjatë viteve 2010-2020.




Fig. 2.9 Kërkesa e gjithmbarshme 2010-2020

Kërkesa e gjithmbarshme e energjisë për vitin 2019 ka qenë 6,001 GWh, ndërsa ngarkesa e pikut gjatë dimrit ka qenë 1,253 MW, ndërsa në vitin 2020 kërkesa e gjithmbarshme ka qenë 6,167 GWh, ndërsa ngarkesa e pikut gjatë dimrit ka qenë 1,249 MW.

Për të vlerësuar ngarkesën e rrjetit të transmetimit, duhet të kryhet një analizë e rrjedhave në rrjet dhe vlerave maksimale të konsumit. Për këtë janë shfrytëzuar pesë (5) vlera të pikut (ngarkesës maksimale) të cilat janë paraqitur për vitet 2019 dhe 2020.

Tabelat në vijim paraqesin pesë vlerat më të larta të ngarkesës për vitin 2019, respektivisht 2020.

Tab. 2.9 Pesë vlerat e pikut në vitin 2019

Ngarkesa maksimale Pmax (MW)	Data	Ora
1,253	12/31/2019	18:00
1,193	12/29/2019	18:00
1,178	1/8/2019	18:00
1,177	1/4/2019	18:00
1,138	1/14/2019	18:00

Tab.2.10 Pesë vlerat e pikut në vitin 2020

Ngarkesa maksimale Pmax (MW)	Data	Ora
1,249	21.12.2020	11
1,239	19.12.2020	18
1,231	31.12.2020	19
1,228	27.12.2020	23
1,207	24.12.2020	23

Diagramet e nxjerra si mesatare e tërë vitit 2019 dhe 2020 tregojnë se prodhimi ditor orë për orë ka qenë me ndryshime të vogla, ndërsa konsumi ka ndryshuar më tepër në intervalet ditë-natë (peak dhe off-peak). Në formësimin e diagrameve ditore ka ndikuar pjesërisht edhe ndërprerja e furnizimit me energji elektrike. Dallimi mes konsumit gjatë ditës dhe atij gjatë natës është mjaft i lartë.




Fig.2.10 Diagrami i mesatares vjetore për orë për vitin 2019




Fig. 2.11 Diagrami i mesatares vjetore për orë për vitin 2020

Dallimi në mes vlerave maksimale dhe minimale të konsumit sipas muajve është mjaftë i madh, dhe në diagramet në vijim janë paraqitur dallimet mes mesatares së vlerave maksimale dhe minimale të konsumit sipas muajve, për vitin 2019 dhe 2020.




Fig. 2.12 Mesatarja mujore e ngarkesave maksimale dhe minimale 2019




Fig. 2.13 Mesatarja mujore e ngarkesës maksimale dhe minimale 2020

Është me rëndësi të analizohet dhe paraqitet pjesëmarrja e kategorive të konsumatorëve në konsumin e përgjithshëm, në mënyrë që të identifikohet struktura e konsumit. Konsumi i energjisë elektrike sipas kategorive të konsumatorëve për vitet 2019 dhe 2020 është paraqitur në tabelën 2.11. Duhet theksuar se konsumatorët vijues: Ferronikeli, Trepça dhe Sharrcemi janë të kyçur në rrjetin e transmetimit.

Tab.2.11 Konsumi sipas kategorisë dhe humbjet

Kategorit e konsumit	2019		2020	
	GWh	Pjesemarrja ne konsum	GWh	Pjesemarrja ne konsum
Konsumi ne amviseri	2,515	41.91%	2,778	45.04%
Konsumi Komerical	1,020	16.99%	963	15.62%
Konsumi industrial	873	14.55%	796	12.90%
Humbjet Komercale	694	11.57%	712	11.55%
Humbjet Teknike	684	11.39%	697	11.30%
Humbjet ne Transmision	105	1.76%	107	1.74%
Konsumi I mbrendshëm i KEK-ut	110	1.83%	114	1.85%
Total	6,001	100.00%	6,167	100.00%

Në figurat 2.13 dhe 2.14 është paraqitur pjesëmarrja në përqindje e kategorive të konsumit (me humbje dhe pa humbje).




Fig. 2.14 Konsumi sipas kategorive 2019




Fig. 2.15 Konsumi sipas kategorive 2020

2.6 Balancimi i kërkesës dhe prodhimit në vitet paraprake

Siç është theksuar edhe më lartë prodhimi i energjisë elektrike në shumicën e viteve ka qenë më i ulët se kërkesa e përgjithshme, por megjithatë është përcjellë me rritje pothuajse të njëjtë me rritjen e kërkesës. Në figurën 2.15 është paraqitur balanca mes prodhimit të energjisë elektrike dhe kërkesës për vitet 2000-2020.




Fig.2.16. Balanca e prodhimit dhe kërkesës për energji elektrike gjatë viteve paraprake (2000-2020)

Gjatë periudhës 2000-2020 kërkesa e gjithmbarshme është rritur për mesatarisht rreth 5.56% në vit. Që nga përfundimi i luftës deri në vitin 2020, njësitë e gjenerimit nuk kanë mbuluar kërkesën për energji elektrike, e cila është kompensuar përmes importit të energjisë elektrike, përveç në vitet 2013, 2016 dhe 2020 kur prodhimi ka tejkaluar kërkesën dhe Kosova ka qenë neto eksportuese e energjisë elektrike. Figura më lartë tregon nivelin e importeve neto, të cilat janë shfrytëzuar për furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike. Importi ndaj kërkesës së gjithmbarshme në periudhën 2000 – 2018 ka qenë 13.84%, ndërsa neto importi për të njëjtën periudhën ka qenë 5.47% të kërkesës së gjithmbarshme në Republikën e Kosovës.

Për periudhën 2019 – 2020, situata sa i përket energjisë elektrike mund të përmblihet si në vijim:

- Prodhimi i energjisë elektrike në vitet 2019 ka qenë më i ulët se kërkesa, ndërsa në vitin 2020 ka qenë më i lartë se kërkesa.
- Humbjet teknike dhe komerciale vazhdojnë të jenë në nivel të lartë me një zvogëlim të lehtë; posaçërisht humbjet komerciale të cilat mbesin shumë të larta, dhe paraqesin sfidë për sektorin e energjisë;
- Norma e arkëtimit ka qenë 99.51% në vitin 2019 dhe 94.244% në vitin 2020;
- Importet e energjisë elektrike vazhdojnë të mbulojnë një pjesë të konsumit të përgjithshëm; dhe
- Balancimi i sistemit të energji elektrike edhe më tej në disa raste është arritur përmes ndërprerjes së furnizimit.

2.7 Parashikimi i kërkesës dhe gjenerimit për periudhën 2019 - 2028

Për furnizim të sigurt të konsumatorëve nevojitet planifikim adekuat i parashikimit të kërkesës dhe gjenerimit të energjisë elektrike duke përfshirë problemet që mund të paraqiten gjatë implementimit. Çështjet me rëndësi rreth furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike janë:

- Rritja e vazhdueshme e konsumit të energjisë elektrike që nuk mund të mbulohet nga gjenerimi në vend;
- Humbjet e përgjithshme të energjisë elektrike që vazhdojnë të jenë të nivelit të lartë;
- Humbjet jo-teknike (shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike) mbeten në nivel të lartë;
- Mungesa e burimeve alternative të energjisë për nevoja të balancimit të sistemit;
- Çmimet e ulëta të energjisë elektrike në krahasim me çmimet e tregut rajonal;
- Çmimet relativisht të larta të burimeve tjera të energjisë (p.sh. naftës, druri, gazi natyror, etj.), që ndikojnë në orientimin e konsumatorëve të përdorin energjinë elektrike për ngrohje.
- Konsumi i rritur i karburanteve të lëngshme që rezulton me rritjen e importeve të përgjithshme të energjisë në Kosovë.

2.7.1 Parashikimi i kërkesës për skenarë të ndryshëm të rritjes ekonomike

Bazuar në bilancin afatgjatë të energjisë për vitet 2019 – 2028 që është miratuar nga ZRRE, në vijim janë paraqitur projeksionet e rritjes së BPV-së gjatë 10 viteve që është në harmoni me Strategjinë e energjisë, të cilat janë shfrytëzuar për të parashikuar kërkesën për energji elektrike.

Tab.2.12 Tre skenarët e rritjes së normës së BPV-së [%] për periudhën 2019-2028

Rritja vjetore [%]	2018	2019	2020-2028
GDP Skenari ultë	2.2%	2.2%	2.2%
GDP Skenari bazë	4.3%	4.3%	4.3%
GDP Skenari lartë	5.4%	5.4%	5.4%

(Skenari bazë konsiderohet më i pranueshëm sa i përket parashikimit të kërkesës)

Skenari i kërkesës bazë për energji elektrike (BDS) parasheh një rritje të lehtë të kërkesës në sektorin e amvisërive, ndërsa një rritje të lartë në sektorin e shërbimeve dhe sektorin industrial. Kërkesa e energjisë (skenari bazë) në vitin 2019 parashihet të jetë 5,814 GWh; ndërsa në vitin 2028 kërkesa parashihet të arrijë 6,170 GWh; ndërsa ngarkesat përkatëse të pikut për vitet e njëjta parashihen të jenë rreth 1,177 MW dhe 1,270 MW.

Kërkesat e energjisë elektrike dhe ngarkesat e pikut për tre skenarët janë paraqitur në tabelën 2.13.

Tab.2.13 Kërkesa e energjisë elektrike dhe ngarkesat e pikut për periudhën 2019 – 2028

Bruto kërkesa [GWh]	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Skenari bazë	5,814	5,835	5,898	5,943	5,991	6,039	6,070	6,102	6,156	6,170
Skenari ultë	5,526	5,532	5,580	5,565	5,616	5,627	5,644	5,644	5,670	5,683
Skenari lartë	6,101	6,150	6,245	6,322	6,400	6,482	6,543	6,607	6,695	6,740

Ngarkesa maksimale [MW]	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Piku bazë	1,177	1,210	1,221	1,231	1,237	1,246	1,251	1,257	1,267	1,270
Piku ultë	1,126	1,145	1,154	1,151	1,158	1,159	1,161	1,160	1,165	1,167
Piku lartë	1,276	1,276	1,294	1,311	1,324	1,340	1,351	1,364	1,381	1,390

Parashikimi i rritjes së kërkesës sipas skenarit të kërkesës së lartë nënkupton investime të arsyetuara pamjaftueshëm apo të parakohshme për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit, si dhe investime për zgjerimin e kapaciteteve të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes.

Në Figurën 2.16 janë paraqitur skenari bazë i rritjes së kërkesës për energji elektrike, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, përfshirë humbjet teknike në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes dhe humbjet komerciale në OSSH (Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes) të shpërndara në kategoritë e konsumatorëve me një përqindje të caktuar (0.85% amvisëria, 0.1% komercial dhe 0.05% industrial), për periudhën 2018-2028.




Fig. 2.17. Skenari bazë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2018-2028, i ndarë sipas kategorive të konsumatorëve

Duhet theksuar se të dhënat mbi parashikimin e konsumit industrial janë ofruar nga Trepça dhe SharrCem (përmes pyetësorëve të KOSTT-it) si dhe nga parashikimi i kërkesës nga Ferronikeli. Zhvillimi i pjesës së mbetur të konsumit industrial, siç janë industria e ushqimit, industria e lehtë, parqet industriale (bizneset prodhuese), etj. kryesisht bazohen në parashikimet e BPV-së si faktori

kryesor për zhvillimin e këtij sektori, përkatësisht për rritjen e konsumit të energjisë elektrike për nevoja industriale.

2.7.2 Parashikimi i gjenerimit të energjisë elektrike

Parashikimi i gjenerimit të energjisë elektrike për periudhën 2019-2028 bazohet në prodhimin e energjisë elektrike nga TC Kosova A, TC Kosova B, HC Ujmani, HC-të në Lumbardhi, centrali me erë KITKA, hidrocentralet e vogla ekzistuese, burimet tjera të ripërtëritshme të energjisë dhe Termocentralit Kosova e Re, si dhe HC Fleksibile.

Skenari bazë i zhvillimit të kapaciteteve të reja të gjenerimit (TC, HC dhe burime të ripërtëritshme) është paraqitur në Tabelën 2.14.

Tab.2.14 Skenari bazë për kapacitetet e reja gjeneruese në të ardhmen

KAPACITETET E REJA GJENERUESE				
		Fuqia e instaluar	Në operim	Jetëgjatësia
Gjeneratorët e rinjë konvencional	TC Kosova e Re			
	G1	P=450 MW	2023	>2050
HC Fleksibile	G1	P=200 MW	2023	>2050
	HC e vogla*	P ₂₀₂₈ =101 MW	2019 - 2028	>2050
Burimet e renovueshme	Turbinat me erë	P ₂₀₂₈ =180 MW	2019 - 2028	2035 - 2045
	Biomasa	P ₂₀₂₈ =16 MW	2019 - 2028	>2050
	Solar	P ₂₀₂₈ =85 MW	2019 - 2028	2035 - 2045

* Në zhvillimin e HC të vogla nuk janë përfshirë edhe ato ekzistuese (Dikanca, Radavci dhe Burimi)

Nga tabelat 2.6 dhe 2.14 mund të konkludohet si në vijim:

- (i) Gjenerimi i energjisë elektrike nga TC Kosova A, duke operuar me njësitë A3, A4 dhe A5 (në pajtim me Direktivën Evropiane për Impiante të Mëdha me Djegie), do të vazhdojë deri në fund të vitit 2023¹.
- (ii) Gjenerimi i energjisë elektrike nga TC Kosova B, duke operuar me blloqet B1 dhe B2 (pritet që këto dy blloqe të rehabilitohen gjatë periudhës 2023 – 2024, përfshirë investimet e domosdoshme për të qenë në pajtueshmëri me standardet e emetimit të përcaktuara nga Direktiva e BE-së për Impiante të Mëdha me Djegie), do të vazhdojë të mbetet në funksion komercial deri në 15 vite pas revitalizimit të tyre, respektivisht deri në vitin 2039.
- (iii) Gjenerimi nga Hidrocentralet Ujmani dhe Lumbardhi dhe centrali me erë Kitka do të mund të vazhdojë operimin komercial për një periudhë afatgjatë me kusht që mirëmbajtja dhe rehabilitimi i tyre të kryhet në mënyrë adekuate.

¹Koha e dekomisionimit të TC Kosova A mund të lidhet me kohën e komisionimit të njësive të TC Kosova e Re.

- (iv) Gjenerimi i energjisë elektrike nga TC Kosova e Re pritet të hyjnë në operim komercial në vitin 2023.
- (v) Gjenerimi i energjisë elektrike nga Hidrocentrali Fleksibil pritet të fillojë në vitin 2023, por ekzistojnë ende mjaft paqartësi rreth implementimit të këtij projekti.
- (vi) Gjatë periudhës 2019-2028² pritet të ndërtohen disa HC të rinj, me kapacitet të gjithmbarshëm instaluar prej 101 MW. Pjesëmarrja e burimeve tjera të ripërtërishme në gjenerimin e energjisë elektrike pritet të realizohet kryesisht nga prodhuesit me erë, ku deri në fund të vitit 2028 pritet që kapacitetet e tilla të arrijnë 180 MW, centrale solare me kapacitet deri në 85MW dhe centralet nga biomasa deri në 16 MW.
- (vii) Deri në fillim të prodhimit nga TC Kosova e Re dhe rehabilitimit të TC Kosova B, kërkesa e pambuluar nga gjenerimi në vend do vazhdojë të mbulohet me importe.

Bazuar në këto supozime, tabela 2.15 paraqet gjenerimin e energjisë elektrike nga impiantet vendore për periudhën 2019 – 2028.

Tab.2.15 Parashikimi i gjenerimit të energjisë elektrike [GWh]

PRODHIMI NETO I ENERGJISE SKENARI BAZË	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
TC KOSOVA A	1,858	1,792	1,792	1,830	0	0	0	0	0	0
TC KOSOVA B	3,224	3,224	3,224	3,224	2,000	1,600	3,628	3,628	3,628	3,628
TC KOSOVA E RE	0	0	0	0	3,370	3,370	3,370	3,370	3,371	3,372
GJITHSEJ NGA TERMOCENTRALET	5,082	5,016	5,016	5,054	5,370	4,970	6,998	6,998	6,999	7,000
HC UJMANI	93	93	93	93	93	93	93	93	93	93
HC (LUMBARDHI+DEQANI+BELAJA)	87	87	87	87	87	87	87	87	87	87
HC NE DISTRIBUCION	57	57	57	57	57	57	57	57	57	57
HC FLEKSIBILE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HC TE VOGLA	109	234	276	317	338	359	380	401	413	421
GJITHSEJ NGA HIDROCENTRALET	346	471	513	554	575	596	617	638	650	658
CENTRALET NGA BIOMASA	0	0	0	7	7	15	15	15	22	22
PE KITKA	96	96	96	96	96	96	96	96	96	96
CENTRALET NGA ERA	0	205	205	293	293	293	293	293	351	351
CENTRALET SOLARE	17	35	41	47	52	58	70	87	93	99
GJITHSEJ BIOMASA, ERA, SOLAR	113	336	341	443	448	461	473	490	562	568
GJITHSEJ RIPËRTËRISHME	366	714	761	904	930	964	997	1,035	1,119	1,133
GJITHSEJ NETO PRODHIMI	5,541	5,822	5,870	6,051	6,394	6,028	8,088	8,126	8,212	8,227

Parashikimi i kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike është paraqitur edhe në mënyrë grafike në Figurën 2.17.

² Të dhënat janë marrë nga dokumenti Bilanci afatgjatë 2019 – 2028 i KOSTT i aprovuar nga ZRRE




Fig. 2.18 Parashikimi i kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike [GWh]

2.7.3 Balanca mes prodhimit dhe konsumit

Balanca e energjisë elektrike gjatë dhjetë viteve të ardhshme merr në konsideratë kërkesën e parashikuar dhe zhvillimin e parashikuar të kapaciteteve gjeneruese dhe nevojave për import dhe eksport të energjisë elektrike. Realizimi i importeve dhe eksporteve të energjisë elektrike varet nga nevojat që do të paraqiten, por edhe nga zhvillimi i tregjeve lokale dhe rajonale të energjisë elektrike. Figura 2.18 paraqet balancën e energjisë elektrike për periudhën 2019 – 2028, të definuar si dallimi mes prodhimit (skenari bazë) dhe kërkesës (skenari bazë).




Fig. 2.19 Balanca e prodhimit dhe kërkesës për energji elektrike në të ardhmen (2019-2028)

Në figurën më lartë është paraqitur ndryshimi në mes prodhimit neto të planifikuar dhe kërkesës së planifikuar pa përfillur energjinë e nevojshme për shërbime ndihmëse (rezerva primare, sekondare dhe terciare) si dhe kapacitetet e pashfrytëzuara të njësive gjeneruese. Vlerat negative



të diferencës sipas figurës paraqesin deficit të energjisë elektrike (nevojës për importe), ndërsa vlerat pozitive paraqesin suficit të energjisë elektrike (mundësisë për eksport).

Duke pasur parasysh se prodhimi i energjisë elektrike nga BRE është i pa parashikueshëm, si dhe lakorja e kërkesës për energji elektrike dallon shumë në mes periudhave ngarkesës maksimale (peak) dhe ngarkesës minimale (off – peak), në periudha të ndryshme paraqiten mungesa të konsiderueshme të energjisë që duhen të mbulohen me importe dhe teprica të energjisë që duhet të eksportohen, dhe kjo imponon nevojën për kapacitete shtesë të gjenerimit.

3. SEKTORI I GAZIT NATYROR

3.1 Përshkrimi i përgjithshëm

Kosova nuk ka prodhim vendor të gazit natyror dhe nuk është e lidhur me ndonjë rrjet funksional të furnizimit me gaz natyror. Lidhja me furnizimin me gaz natyror do të ishte një opsion i rëndësishëm për futjen e gazit natyror në Kosovë, i cili do të ndikonte në diversifikimin e furnizimit me karburant në vend dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit.

Prandaj, furnizimi dhe konsumi i gazit në Kosovë është i kufizuar në LPG të ambalazhuar (gaz i lëngshëm i naftës).

3.2 Korniza ligjore dhe institucionale

Me qëllim të krijimit të perspektivës për zhvillimin e sektorit të gazit natyror dhe përmbushjes së obligimeve që Kosova ka si anëtare me të drejta të plota në Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Kuvendi i Kosovës në qershor 2016 miratoi Ligjin nr. 05/L-082 për Gazin Natyror, si pjesë e pakos së ligjeve për energjinë.

Me miratimin e këtij ligji është transpozuar legjislacioni i pakos së tretë evropiane relevant për gazin natyror; kryesisht:

- Direktiva nr. 2009/73/KE lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror; dhe
- Rregullorja nr. 715/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetet e transmisionit të gazit natyror.

. Ligji për gazin natyror vendos themelet e kornizës ligjore dhe rregullatore për transmisionin, shpërndarjen, ruajtjen dhe furnizimin e gazit natyror dhe funksionimin e sistemeve të transmisionit dhe shpërndarjes së gazit. Për rrjedhojë, ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror dhe aksesin në rrjete dhe tregun e gazit.

3.3 Përshkrimi i rolit të autoritetit rregullator dhe/ose autoriteteve të tjera

Ligji 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë themeloi një Rregullator të fuqishëm, plotësisht të pavarur (Zyrën e Rregullatorit të Energjisë - ZRRE), plotësisht autonom nga çdo departament qeveritar për të ushtruar rregulloren ekonomike në sektorin e energjisë (Energjia, Ngrohja Qendrore dhe Gazi Natyror) dhe përcaktoi kompetencat, detyrat dhe funksionet e tij ekzekutive, ndër të cilat kryesisht janë:

- Bën lëshimin, ndryshimin, pezullimin, transferimin dhe përfundimin e licencave për kryerjen e aktiviteteve energjetike;
- Mbikëqyr, monitoron dhe siguron respektimin e licencave;
- Monitoron funksionimin e tregjeve të energjisë në Kosovë, duke përfshirë kushtet e qasjes për palët;
- Jep autorizime për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe sistemeve të tubacioneve të gazit, duke përfshirë linjat e drejtpërdrejta të energjisë elektrike dhe tubacionet e drejtpërdrejta;



- Bën zhvillimin dhe nxjerrjen e metodologjive tarifore, si dhe përcaktimin dhe miratimin e tarifave për shërbimet e rregulluara;
- Përcakton kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji;
- Monitoron dhe ndërmerr veprime të përcaktuara me ligj për të promovuar dhe rritur sigurinë e furnizimit me energji;
- Monitoron ndarjen dhe zhvillimin efektiv të konkurrencës në sektorin e energjisë, dhe
- Rishikon dhe miraton masa për mbrojtjen e konsumatorëve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në sektorin e energjisë.

Themelimi i ZRRE-së bie në kornizën më të gjerë të harmonizimit të politikave energjetike në Evropën Juglindore, ku Kosova është 'palë kontraktuese' e Komunitetit Energjetik të Evropës Juglindore (ECSEE).

3.4 Kapaciteti aktual i prodhimit dhe importit

Në Kosovë nuk ka prodhim të gazit dhe as kapacitet importi me tubacione.

3.5 Investimet në prodhim dhe import për tre vitet e ardhshme

Autorizuar – Aktualisht nuk ka projekte investimi të autorizuar.

Aktualisht në proces ndërtimi - Nuk ka asnjë projekt në ndërtim.

Kërkesat në lidhje me furnizuesin e zgjidhjes së fundit - Nuk ka kërkesa të veçanta.

Stimujt për të rritur kapacitetin e prodhimit/importit apo çfarëdo lloji - Nuk ka stimuj specifikë.

3.6 Progresi në projekte të mëdha infrastrukturore

Projektet e rëndësishme të interkoneksionit ndërmjet ose brenda shteteve anëtare

Krahas projektit ALKOGAP – Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë, për të cilin Studimi i Prefizibilitetit përfundoi në vitin 2018, gjatë periudhës raportuese ka pasur iniciativa të tjera për zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Kosovë.

Në vitin 2020, në kuadër të Programit Kompakt MCC është përgatitur studimi për Zhvillimin e Sektorit të Gazit në Kosovë, i cili ka vlerësuar opsionet më të favorshme për futjen e gazit natyror në Kosovë dhe zhvillimin e infrastrukturës përkatëse të gazit me fokus ndërlidhjen me Maqedoninë e Veriut.

Po ashtu, këtë vit ka filluar Plani për Zhvillimin e Gazit të Kosovës dhe Rishikimi dhe Asistenca Rregullative, i cili financohet përmes platformës WBIF, me BERZH-in si IMN kryesor. Plani do të trajtojë zhvillimin e masterplanit gjithëpërfshirës afatmesëm të gazit dhe identifikimin e projektit me synimin kryesor zhvillimin e infrastrukturës së gazit dhe të asaj që ndërlidhet me gazin brenda vendit. Përveç kësaj, ai përfshin rishikimin e kornizës rregullative, vlerësimin organizativ dhe institucional dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM).

Në kuadër të këtyre studimeve janë duke u përpunuar komponentët kryesorë të mëposhtëm:

- Projektet e kërkesës për gaz për periudhën afatgjatë që kanë përfshirë: sektorët e banimit dhe shërbimeve, industrinë, sektorin e ngrohjes qendrore dhe prodhimin e energjisë elektrike.
- Vlerësimi i opsionit më të favorshëm për furnizim me gaz natyror – vlerësimi i interkonektorëve të gazit në kuadër të opsioneve rajonale dhe më të favorshme për zhvillimin e rrjetit të brendshëm të gazit.
- Studimi paraprak dhe përcaktimi i kanalit të gazsjellësit, si dhe përcaktimi i parametrave teknikë të tubacionit dhe stacioneve dhe pajisjeve përkatëse.
- Analiza financiare dhe analiza e kostos së përfitimit duke përfshirë vlerësimin e kostove të investimit dhe kostos së operacioneve dhe mirëmbajtjes.




Fig. 3.1: Projektet e infrastrukturës rajonale të gazit dhe opsionet për kyçe të Kosovës

4. SEKTORI I NAFTËS

4.1 Korniza ligjore dhe institucionale

Ligji kryesor që rregullon sektorin e naftës në Kosovë është Ligji nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në fuqi që nga viti 2004, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-138 të viti 2009. Ligji zbatohet për furnizimin me shumicë dhe pakicë, transportin dhe deponimin e naftës dhe produkteve të naftës.

Departamenti për rregullimin e tregut të naftës funksionon në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit të lartpërmendur dhe është përgjegjës për rregullimin, përkatësisht licencimin, e aktiviteteve të sektorit të naftës në Kosovë. Ndërsa monitorimin dhe mbikëqyrjen e tregut të naftës e kryen Inspektorati i Tregut, i cili funksionon edhe në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Një projektligj për tregtinë me naftën dhe biokarburantet është në proces ri-hartimi, me qëllim që të transpozohet plotësisht Direktiva Evropiane përkatëse – përkatësisht Direktiva 2009/28/KE për promovimin e përdorimit të biokarburanteve dhe Direktiva nr. 2009/119/KE për Stoqet Minimale të Naftës. Aktualisht ky projektligj është në procedurë të miratimit nga Qeveria dhe Kuvendi.

Me qëllim të transpozimit të plotë dhe zbatimit të Direktivës 1999/32/KE për kufizimin e përmbajtjes së squfurit në lëndë djegëse të caktuara (mazuti dhe benzina), në nëntor 2020 u miratua Udhëzimi Administrativ nr. 09/2020 për cilësinë e derivateve të naftës, me të cilin është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ nr. 01/2017. Në përputhje me këtë udhëzim, cilësia e derivateve të naftës kontrollohet në terminalin doganor nga zyrtarët doganorë. Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ nr. 07/2018 përcakton procedurat e licencimit për subjektet tregtare që ushtrojnë aktivitetet në sektorin e naftës, përkatësisht për kryerjen e këtyre aktiviteteve afariste:

- Importi i naftës dhe dizelit për konsum të përgjithshëm;
- Magazinimi i produkteve të naftës dhe dizelit;
- Tregtia me shumicë e naftës dhe dizelit;
- Shitja me pakicë e naftës dhe dizelit.

4.2 Furnizimi vendor me naftë bruto dhe derivate të naftës

Kosova nuk ka as rezerva vendore të naftës bruto dhe as kapacitete për përpunimin e naftës bruto dhe për këtë arsye nuk importon naftë bruto. Kosova është importues neto i derivateve të naftës, dhe prodhon vetëm naftë të rëndë për ngrohje nga lënda e parë e importuar që përbën afërsisht 30% të konsumit të naftës së rëndë për ngrohje. Janë katër fabrika të licencuara prodhimi, të cilat aktualisht prodhojnë naftë të rëndë me më pak se 1% përmbajtje squfuri; Mazuti i rëndë me më pak se 1% përmbajtje squfuri prodhohet nga përzierja e vajit të rëndë që përmban mbi 1% squfur me vajra të lehta si benzina dhe vajguri.

4.3 Importi dhe konsumi i naftës bruto dhe produkteve të naftës

Kosova është importues neto i produkteve të naftës. Duke qenë se ka sasi të papërfillshme të prodhimit vendas dhe eksporteve, pothuajse i gjithë konsumi brenda vendit mbulohet nga

importi. Në vitet e fundit, importi i përgjithshëm i produkteve të naftës nuk ka patur trend rritës të dukshëm, por vetëm variacione të lehta.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat për konsumin, importin dhe eksportin (sasi të papërfillshme).

Tabela 4.1: Të dhënat për produktet e naftës në vitin 2019 (në 1000 tonë)

Petroleum Products - 2019 [in tons]			
Type	Imports	Exports	Consumption
Benzine	58,954.2	0	58,954.2
Biodizel	0.0	0	0.0
Bitumen	54,715.9	67.1	54,648.8
Dizel	510,577.3	0	510,577.3
Bottled natural gas	604.4	2	602.4
Gazoilet	3,673.7	0	3,673.7
LPG	29,289.6	0	29,289.6
Jet fuel	2,409.9	0	2,409.9
Koks naftë	123,861.1	13,677.8	110,183.3
Mazut	22,247.6	0	22,247.6
Lubricants	5,615.0	149.2	5,465.8
Total	811,948.7	13,896.1	798,052.6

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës – www.ask.rks-gov.net




Figura 4.1 Paraqitja grafike e të dhënave për derivatet e naftës në Kosovë në vitin 2019

Tabela 4.2: Të dhënat për produktet e naftës në vitin 2020 (në 1000 tonë)

Petroleum Products - 2020 [in tons]			
Type	Imports	Exports	Consumption
Benzine	50,144.3	0	50,144.3
Biodizel	0.0	0	0.0
Bitumen	50,260.8	5.2	50,255.6
Dizel	498,324.6	0	498,324.6
Bottled natural gas	671.5	2	669.5
Gazoilet	7,745.0	0	7,745.0
LPG	23,741.5	0	23,741.5
Jet fuel	2,067.1	0	2,067.1
Koks naftë	113,396.9	7,927.8	105,469.1
Mazut	252.8	0	252.8
Lubricants	6,196.4	278.2	5,918.2
Total	752,800.9	8,213.2	744,587.7


 Source: Agjencia e Statistikave të Kosovës – www.ask.rks-gov.net


Figura 4.2 Paraqitja grafike e të dhënave për derivatet e naftës në Kosovë në vitin 2020

4.4 Varësia nga importet dhe origjina e karburanteve të importuara

Kosova është pothuajse 100% e varur nga importi i derivateve të naftës dhe ato kryesisht importohen nga vendet e rajonit.

4.5 Rezervat e naftës bruto dhe të derivative të naftës

Ligji për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës detyron të gjitha objektet e magazinimit të naftës dhe derivateve të naftës dhe pikat e shitjes që të mbajnë rezerva të paktën 5% të kapacitetit të tyre depozitues në çdo kohë për qëllime emergjente. Kapacitetet aktuale të licencuara të magazinimit kanë afërsisht 80,000 m³ dhe afërsisht 40,000 m³ për shitjen me pakicë të karburanteve, prandaj 5% e këtij kapaciteti është e barabartë me 3-4 ditë import mesatar ditor neto. 50,000 m³ kapacitete magazinimi nuk shfrytëzohen dhe nuk janë të licencuara për magazinim të karburanteve. Aktualisht 12 depo që janë të licencuara për tregtimin me shumicë të karburanteve (naftë, benzinë, LPG).

Tabela 4.3 tregon udhërrëfyesin e propozuar nga Komuniteti i Energjisë për Kosovën për të përmbushur detyrimet e Direktivës 2009/119/KE deri në fund të vitit 2020.

Tabela 4.3: Udhërrëfyesi i Kosovës për arritjen e rezervave emergjente të naftës

Task	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Legal										
Develop regulatory framework/laws										
Enact relevant laws and regulations										
Organisational and Management										
Develop strategy and organisation for managing stocks										
Set up Central Stockholding Entity (as required)										
Develop stockholding obligations for operating companies (if required)										
Development of Emergency Response Planning										
Development of Inventory monitoring and reporting system										
Engineering										
Secure Engineering Budget										
Assess and design additional tank capacity										
Engineering design for additional tank capacity										
Tender for storage construction										
Build required additional tank capacity										
Stockbuilding										
Arrange financing for purchasing of emergency stocks										
Build-up emergency stocks										
Report compliance progress to the Energy Community										

4.6 Infrastruktura e naftës

Kosova nuk posedon tubacion për naftë bruto dhe as për produkte të naftës. Produktet e naftës importohen 75% me transport rrugor dhe 25% me hekurudhë.

4.7 Tarifa doganore e importit/eksportit

Kosova ka një treg të hapur për produktet e naftës duke përfshirë importin dhe eksportin, dhe çmimet vendosen lirisht nga tregu. Sa i përket tarifës doganore 10%, kjo çështje trajtohet nga legjislacioni përkatës në fuqi, i cili përmbush detyrimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare (CEFTA, Traktati i Komunitetit të Energjisë) për sektorin e naftës; konkretisht, Ligji nr. 04/L-163 dhe Udhëzimi Administrativ nr. 05/2015, i ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr. 07.2016 për mallrat për të cilat nuk ngarkohet tarifa doganore, specifikon produktet e naftës që lirohen nga taksa doganore si: karburantet, vajrat, lubrifikantët, bitumi dhe koksi i benzinës i kalcinuar dhe i dekalcinuar.



4.8 Rregullimi i çmimeve, roli i autoritetit rregullator

Sipas Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës, autoriteti përgjegjës për sektorin e naftës në Kosovë është Departamenti për Rregullimin e Sektorit të Naftës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Ky departament ka kompetencat për licencimin e subjekteve tregtare për kryerjen e veprimtarive në sektorin e naftës. Rregullimi i çmimeve nuk zbatohet pasi tregu është shumë konkurrues me mbi 40 importues të karburanteve të transportit dhe shumë importues të tjerë të derivateve të tjera të naftës. Çmimet me shumicë dhe pakicë përcaktohen lirisht nga forcat e tregut.

5. KONKLUZIONE

Sektori i energjisë i Kosovës pjesërisht bazohet në burime vendore dhe pjesërisht në importe. Energjia elektrike përmbush mbi 90% të nevojave nga prodhimi vendor, ndërsa sa i përket gazit natyror, duhet theksuar se nuk ka të zhvilluar fare rrjet, kurse e tërë nafta dhe derivatet e saj vijnë nga importi.

Pjesa e sektorit të energjisë elektrike ka përparime si në kapacitetet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të konsumatorëve në përgjithësi.

- Janë bërë investimet në pajisje të reja në stabilimente energjetike si dhe në mirëmbajtje, por edhe në prodhim sidomos nga Burimet e ripërtëritshme të energjisë.
- Rrjeti i transmetimit është në gjendje të mirë, pas investimeve të bëra në infrastrukturën fizike. Kapacitetet transmetuese plotësojnë kriteret e kërkuara sidomos me ndërtimin dhe funksionalizimin e linjës 400kV Kosovë – Shqipëri.
- Bllokimi nga ana Serbisë e alokimit të kapaciteteve transmetuese ndërkufitarë për përdorim komercial mbetet çështje mjaft e rëndësishme e cila ka ndikim në sigurinë e furnizimit në vend dhe rajon.
- Rrjeti i distribucionit ende mbetet në gjendje jo të kënaqshme dhe nevojiten investime për të siguruar furnizim cilësor dhe të qëndrueshëm për konsumatorëve.
- Nuk ka pasur reduktime të energjisë për konsumatorë për shkak të mungesës së energjisë.
- Gjendja e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike për periudhën 2019 – 2020 mund të konsiderohet e pranueshme, por në mënyrë që të ketë kualitet më të mirë të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike, nevojiten investime të vazhdueshme posaçërisht në rrjetin e shpërndarjes, por edhe në prodhim.
- Mbetet më problematike çështja e balancimit të sistemit, meqë nuk ka rezerva të mjaftueshme të kapacitetit prodhues e sidomos ato fleksibile të cilat do të mund të aktivizoheshin në rastet e mungesës së energjisë elektrike apo të rënieve të ndonjë njësie më të madhe. Kështu për mbulimin e pikut të konsumit nevojiten importe të energjisë elektrike, ndërsa për periudhën jashtë pikut sidomos gjatë natës paraqiten teprica të energjisë elektrike të cilat mund të eksportohen.

Sipas Strategjisë së Energjisë 2017 – 2026 për të mbuluar kërkesën vendore të energjisë elektrike e cila është në rritje, dhe potencialisht për të eksportuar energji elektrike, parashihet ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese që do të rezultojnë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Sa i përket gazit natyror Kosova nuk ka prodhim vendor të gazit natyror dhe nuk është i lidhur me ndonjë rrjet operacional të furnizimit me gaz natyror.

Mbetet çështje e rëndësishme:

- Një lidhje me ndonjë nga rrjetet regjionale për të mundësuar furnizimin me gaz natyror do të ishte një opsion i rëndësishëm për futjen e gazit natyror në Kosovë;



- Janë në zhvillim e sipër studime dhe plane për ndërlidhjen me rrjetet regjionale të gazit, që pas përfundimit të projektit TAP, janë aktualizuar dhe pritet të operacionalizohen së shpejti.

Kosova nuk ka burime të naftës së parafinuar dhe as kapacitete për përpunimin e saj, pra Kosova është importuese e produkteve të naftës.

- Aktualisht ekzistojnë 12 stabilimente depozitimi që janë të licencuara për shitje të karburanteve me shumicë (naftë, benzinë, GLN).
- Çmimet me shumicë dhe pakicë janë vendosur lirisht nga tregu dhe ka konkurrencë të konsiderueshme.

Fundi i dokumentit